



REPUBLIKA E SHqipëRISE  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DHE EKONOMISË

# RAPORT VJETOR

FINANCAT PUBLIKE VENDORE

2020





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DHE EKONOMISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT  
DREJTORIA E FINANCAVE VENDORE

# Raport Vjetor 2020

## Financat Publike Vendore

Maj 2021



## ***Të nderuar kryetarë, financierë, përdorues dhe lexues të tjerë të raportit,***



Në vitet e fundit Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në drejtim të reformave të menaxhimit financiar si në nivel qendror ashtu edhe vendor. Reforma administrative- territoriale, konsolidimi i decentralizimit funksional dhe fiskal, u shoqëruan me rritjen e nivelit të shërbimeve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Implementimi i këtyre reformave kanë dhënë efekt të konsiderueshëm në potencialin fiskal të pushtetit vendor, duke rritur kapacitetet për mbledhjen e të ardhurave të veta vendore për rrjedhojë edhe fondet për shërbimet dhe investimet publike vendore.

Miratimi dhe zbatimi i Ligjit Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore ka ndikuar drejtpërsëdrejti në përmirësimin e menaxhimit të financave publike në nivel vendor. Në zbatim të këtij ligji, miratimi i një sër aktesh nënligjore forcoi ciklin e menaxhimit financiar në nivel vendor ku përfshihet hartimi, zbatimi dhe raportimi mbi bazë performance buxhetore. Një risi në këtë kuadër është tashmë miratimi i një procedure të detajuar për menaxhimin e vështirësive financiare në nivel vendor.

Decentralizimi i funksioneve dhe mbulimi i plotë i efektit financiar për të siguruar “cilësinë e shërbimeve ishte fillimi i një eksperience të rëndësishme në konsolidimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore. Viti 2020, ishte një vit shumë i rëndësishëm i cili tregoi që tashmë pushteti vendor ka forcuar ndjeshëm kapacitetet fiskale dhe gjithashtu aftësinë për të ofruar shërbime publike që rrisin drejtpërdrejt cilësinë e jetës së qytetarëve. Tejkalimi i situatës pandemike me shumë sukses nga të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe rikuperimi i planit të treguesve fiskalë të të ardhurave dhe shpenzimeve duke ruajtur qëndrueshmërinë fiskale janë rezultat i përmirësimit të dukshëm të menaxhimit financiar në nivel vendor.

Është kënaqësi për mua të ndaj me ju raportin e tretë zyrtar të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e buxhetit vendor 2020, i cili është dedikuar tërësisht tendencave dhe performancës së financave vendore. Raporti është një vijimësi e përpjekjeve të MFE për rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë mbi përdorimin e financave publike në nivel qendror dhe vendor. Ky raport, gjithashtu përmban informacion të detajuar financiar për njësitë e vetëqeverisjes vendore, i paraqitur në mënyrë të thjeshtëzuar për të ndihmuar të gjithë qytetarët dhe grupet e interesit të kuptojnë më shumë në lidhje me menaxhimin financiar në nivel vendor, e për t’iu lehtësuar edhe pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrjen e autoriteteve vendore. Përrjashtimisht, një pjesë e rëndësishme e këtij raporti paraqet performancën e financave vendore në kushtet e Pandemisë COVID-19, si dhe ndikimit nga tërmeti i fundvitit 2019.

Raporti është hartuar nga Drejtoria e Financave Vendore e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me mbështetjen e Projektit të Qeverisë Zvicerane “Financat Lokale”, duke sjellë kështu edhe një perspektivë të rëndësishme në menaxhimin financiar në nivel vendor.

**MINISTËR**  
  
**Anila Denaj**

Ky raport është përgatitur me mbështetjen e projektit 'Financat Lokale' nga Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike SECO

**FINANCATLOKALE** | Forcimi i Menaxhimit  
**LOCALFINANCES** | të Financave Publike  
të Qeverisjes Vendore



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike, SECO**

# Përmbajtja

<b>1. Hyrje mbi raportin e realizimit të buxhetit vendor 2020.....</b>	<b>15</b>
<b>2. Ecuria e implementimit të proceseve të menaxhimit të financave vendore gjatë vitit 2020.....</b>	<b>18</b>
<b>3. Analiza e treguesve të përgjithshëm të buxhetit vendor 2020.....</b>	<b>20</b>
<b>3.1 Të ardhurat e pushtetit vendor.....</b>	<b>24</b>
<b>3.2 Shpenzimet e pushtetit vendor .....</b>	<b>33</b>
<b>3.3 Detyrimet e prapambetura.....</b>	<b>40</b>
<b>4. Procesi i rindërtimit në treguesit fiskalë të pushtetit vendor.....</b>	<b>41</b>
<b>5. Analiza e buxheteve sipas njësive të vetëqeverisjes vendore.....</b>	<b>42</b>
<b>5.1 Analiza e buxheteve sipas bashkive në të ardhura dhe shpenzime.....</b>	<b>42</b>
152 Bashkia Belsh.....	42
102 Bashkia Berat.....	44
103 Bashkia Bulqizë.....	46
110 Bashkia Cërrik.....	48
104 Bashkia Delvinë.....	50
105 Bashkia Devoll.....	52
106 Bashkia Dibër.....	54
147 Bashkia Divjakë.....	56
452 Bashkia Dropull.....	58
107 Bashkia Durrës.....	60
109 Bashkia Elbasan.....	62
111 Bashkia Fier.....	64
326 Bashkia Finiq.....	66
155 Bashkia Fushë-Arrëz.....	68
115 Bashkia Gjirokastër.....	70
114 Bashkia Gramsh.....	72
117 Bashkia Has.....	74
160 Bashkia Himarë.....	76
166 Bashkia Kamëz.....	78
118 Bashkia Kavajë.....	80
154 Bashkia Këlcyrë.....	82
654 Bashkia Klos.....	84
120 Bashkia Kolonjë.....	86
156 Bashkia Konispol.....	88
122 Bashkia Korçë.....	90
123 Bashkia Krujë.....	92
124 Bashkia Kuçovë.....	94
125 Bashkia Kukës.....	96
126 Bashkia Kurbin.....	98
127 Bashkia Lezhë.....	100
116 Bashkia Libohovë.....	102
128 Bashkia Librazhd.....	104

129	Bashkia Lushnjë.....	106
130	Bashkia Malësi e Madhe.....	108
168	Bashkia Maliq.....	110
132	Bashkia Mallakastër.....	112
131	Bashkia Mat.....	114
143	Bashkia Memaliaj.....	116
132	Bashkia Mirditë.....	118
112	Bashkia Patos.....	120
134	Bashkia Peqin.....	122
135	Bashkia Përmet.....	124
136	Bashkia Pogradec.....	126
140	Bashkia Poliçan.....	128
153	Bashkia Prrenjas.....	130
137	Bashkia Pukë.....	132
499	Bashkia Pustec.....	134
119	Bashkia Rrogozhinë.....	136
113	Bashkia Roskovec.....	138
137	Bashkia Sarandë.....	140
159	Bashkia Selenicë.....	142
108	Bashkia Shijak.....	144
141	Bashkia Shkodër.....	146
139	Bashkia Skrapar.....	148
142	Bashkia Tepelenë.....	150
101	Bashkia Tiranë.....	152
145	Bashkia Tropojë.....	154
167	Bashkia Ura Vajgurore.....	156
157	Bashkia Vau i Dejës.....	158
146	Bashkia Vlorë.....	160
165	Bashkia Vorë.....	162

**5.2 Analiza e buxheteve sipas Këshillave të Qarqeve në të ardhura dhe shpenzime..... 164**

042	Këshilli i Qarkut Berat.....	164
046	Këshilli i Qarkut Dibër.....	165
047	Këshilli i Qarkut Durrës.....	166
048	Këshilli i Qarkut Elbasan.....	167
049	Këshilli i Qarkut Fier.....	168
011	Këshilli i Qarkut Gjirokastër.....	169
015	Këshilli i Qarkut Korçë.....	170
018	Këshilli i Qarkut Kukës.....	171
033	Këshilli i Qarkut Shkodër.....	173
035	Këshilli i Qarkut Tiranë.....	174
037	Këshilli i Qarkut Vlorë.....	175

**6. Objektivat e treguesve të financave publike vendore për vitin 2021..... 176**

**7. Konkluzione dhe Synimet në vijim..... 178**



## Lista e grafikeve

Grafiku 1: Plan/Fakt i të ardhurave dhe shpenzimeve të pushtetit vendor gjatë vitit 2020.....	20
Grafiku 2: Realizimi mujor i të ardhurave dhe shpenzimeve të pushtetit vendor 2020.....	21
Grafiku 3: Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve në vitin 2020 dhe vitin 2015.....	22
Grafiku 4: Të ardhurat vendore në raport me totalin e të ardhurave publike dhe PBB.....	23
Grafiku 5: Realizimi i shpenzimeve të pushtetit vendor në vite dhe në raport me totalin të shpenzimeve publike e PBB.....	23
Grafiku 6: Realizimi i të ardhurave tatimore dhe jotatimore në vitin 2019 dhe 2020.....	24
Grafiku 7: Të ardhurat tatimore të pushtetit vendor në vite dhe ritmi i ndryshimit.....	25
Grafiku 8: Transferata e pakushtëzuar në vite 2011-2020.....	25
Grafiku 9: Të ardhurat e pushtetit vendor sipas burimit në vite.....	26
Grafiku 10: Të ardhurat e veta të pushtetit vendor sipas burimit në vite.....	27
Grafiku 11: Pesha e të ardhurave të pushtetit vendor sipas burimit në vitin 2020.....	27
Grafiku 12: Të ardhura nga taksat dhe tarifata vendore gjatë vitit 2020.....	28
Grafiku 13: Norma e ndryshimit të të ardhurave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore 2020/2019.....	29
Grafiku 14: Realizimi i shpenzimeve të pushtetit vendor në vite dhe ritmi i ndryshimit në vite.....	33
Grafiku 15: Shpenzimet sipas llogarive ekonomike të pushtetit vendor për vitin 2020-2019.....	34
Grafiku 16: Pesha e shpenzimeve sipas llogarive ekonomike të pushtetit vendor për vitin 2020-2019.....	35
Grafiku 17: Pesha e shpenzimeve të pushtetit vendor sipas klasifikimit funksional për vitet 2020-2019.....	36
Grafiku 18: Pesha e shpenzimeve të pushtetit vendor sipas burimit të financimit për vitin 2020-2019.....	36
Grafiku 19: Ndryshimi i shpenzimeve në nivel funksioni 2020/2019.....	37
Grafiku 20: Shpenzimet e pushtetit vendor sipas funksioneve dhe burimit të financimit gjatë vitit 2020.....	38
Grafiku 21: Norma e ndryshimit të shpenzimeve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore 2020/2019.....	39

## Lista e tabelave

Tabela 1: Të ardhurat e veta sipas bashkive.....	31
Tabela 2: Të ardhurat e veta sipas qarqeve.....	33
Tabela 3: Detyrimet e prapambetura sipas kategorive.....	40
Tabela 4: Fondet e rindërtimit sipas bashkive përfituese.....	41

## Shkurtime

MFE	– Ministria e Financave dhe Ekonomisë
PBB	– Produkti i Brendshëm Bruto
NJVQV	– Njësi të Vetëqeverisjes Vendore
MFP	– Menaxhimi i Financave Publike
PBA	– Programi Buxhetor Afatmesëm
INSTAT	– Instituti i Statistikave
NALAS	– Network of Associations of Local Authorities of South-East Europe
OECD	– Organisation for Economic Co-operation and Development
SIFQ	– Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë



## Përmbledhje ekzekutive

Pushteti vendor luan një rol mjaft të rëndësishëm si në cilësinë e shërbimeve që janë shumë afër jetës së qytetarëve ashtu edhe si një instrument i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të shoqërisë në tërësi. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka vendosur në objektivat e saj strategjike decentralizimin fiskal dhe modernizimin e menaxhimit të financave publike në nivel vendor. Krijimi i hapësirës së nevojshme fiskale dhe kapaciteteve njerëzore për zbatimin e funksioneve ligjore është një ndër synimet bazë të forcimit të rolit të pushtetit vendor. Duke iu referuar praktikave dhe asistencës më të mirë ndërkombëtare të menaxhimit të financave publike në nivel vendor, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka krijuar hapësirën e nevojshme për orientimin e politikave publike vendore mbi bazën e performancës buxhetore.

Potenciali i përfituar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore pas miratimit të reformës administrativo-territoriale ka rritur kapacitetet njerëzore në menaxhimin e proceseve zhvillimore në tërësi dhe eficiencën e ushtrimit të funksioneve me një kosto sa më të ulët në veçanti. Viti 2020, do të konsiderohet një vit jo i zakonshëm jo vetëm për shoqërinë por edhe për ciklin e zhvillimit të ekonomisë globale dhe Shqiptare.

Viti 2020, ishte një provë e rëndësishme për konsolidimin e financave të pushtetit vendor në raport me trendin e treguesve fiskalë pas reformës administrativo-territoriale. Financat vendore në vite kanë pësuar një rritje jo vetëm të të ardhurave të veta por gjithashtu edhe të financimit të plotë të funksioneve të transferuara nga pushteti qendror. Vazhdimësia e këtij raporti do të shërbejë si një bazë e rëndësishme analitike e të dhënave fiskale të pushtetit vendor, por gjithashtu krahasimi me ecurinë e tyre ndër vite.

Në raport me treguesit makroekonomikë dhe fiskalë të ekonomisë në tërësi dhe të të ardhurave publike, gjatë vitit 2020 do të evidentojmë disa elementë të rëndësishëm si më poshtë:

- Trendi rritës i raportit të të ardhurave vendore me totalin e të ardhurave publike, dëshmon për përmirësim në procesin e konsolidimit financiar të pushtetit vendor. Nga **3.09%** në vitin 2015, në vitin 2016 rreth **3.67%**, në vitin 2019 rreth **5.02%** dhe vlerën më të lartë arrin në vitin 2020 në rreth **5.16%**.
- Pushteti vendor ka rritur rolin e tij në vite përmes kontributit në ekonomi e në Produktin e Brendshëm Bruto. Raporti i të ardhurave vendore ndaj PBB-së ka ruajtur një trend të vazhdueshëm rritjeje nga **2.38%** në vitin 2015, **3.35%** në vitin 2019 dhe duke arritur në **3.38%** në vitin 2020.
- Gjatë vitit 2020, në krahasim me vitin 2019, raporti i shpenzimeve të pushtetit vendor me Produktin e Brendshëm Bruto, ka pësuar një rritje të lehtë prej **0.1% duke arritur në vlerën e rreth 3.38%**. Kjo ka ardhur jo vetëm për shkak të rritjes së shpenzimeve të pushtetit vendor por edhe rënies së produktit të brendshëm bruto si pasojë e pandemisë COVID-19.
- Raporti i shpenzimeve të pushtetit vendor ndaj totalit të shpenzimeve publike gjatë vitit 2020 ka rezultuar në vlerën e rreth **9.59% ose rreth 1.8%** më pak së një vit më parë. Rënia e këtij raporti gjatë vitit 2020 vjen për shkak se rritja e shpenzimeve të përgjithshme publike ka patur një normë më të lartë se rritja e shpenzimeve të pushtetit vendor.

Duke iu referuar analizave të mëparshme vjetore të zhvilluara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë lidhur me treguesit fiskalë të pushtetit vendor, natyrshëm është evidentuar mungesa e burimeve të mjaftueshme financiare të NJVQV-ve për rritjen e standardit të ofrimit të shërbimeve publike. Pandemia COVID-19 dhe efekti në ekonominë vendore nga rindërtimi do të jenë gjithashtu elementë të rëndësishëm analize gjatë përshkrimit të treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve vendore në vitin 2020. Në këtë kontekst, si më poshtë do të evidentojë rëndësinë e menaxhimit të financave në cilësinë e arkëtimit të të ardhurave për pushtetin vendor, si një formë për të rritur transparencën dhe përgjegjshmërinë e përdorimit të parave publike.

- Pushteti vendor gjatë vitit 2020, ka realizuar të ardhura të veta tatimore dhe jotatimore rreth **24.2 miliard lekë** ose ndryshe rreth **5%** më pak se të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2019.
- Nga totali i të ardhurave vendore rreth **21.9 miliard lekë** janë të ardhura tatimore ose rreth **90%** e totalit të të ardhurave vendore, këto të ardhura janë realizuar rreth **5.1%** më pak se e njëjta periudhë e vitit 2019. Ndërkohë, të ardhurat jotatimore të pushtetit vendor gjatë vitit 2020 të cilat arriten rreth **2.2 miliard lekë**, ose **10%** e totalit të të ardhurave vendore, janë realizuar rreth **12%** më pak të ardhura në raport me vitin 2019.
- Në 6 mujorin e parë të vitit 2020, që përkon me periudhën e rënies ekonomike nga pandemia COVID-19, pushteti vendor ka arkëtuar rreth **7 miliard lekë** ose **32%** të totalit të të ardhurave vjetore prej 21.9 miliard lekë. Pjesa tjetër prej **14.9 miliard lekë** ose rreth **68%** e totalit vjetor është arkëtuar nga pushteti vendor në gjysmën e dytë të vitit 2020.
- Taksat vendore në vitin 2020 u arkëtuan rreth **17.6 miliard lekë**, ose me një rënie rreth **5.3% më pak se të ardhurat e taksave vendore gjatë vitit 2019**.
- Të ardhurat nga tarifatat në vitin 2020 janë mbledhur vetëm **6.5 miliard lekë** ose rreth **5.7% më pak se të ardhurat e këtij burimi në vitin 2019**. Të ardhurat nga ky burim zënë vetëm **27%** e totalit të të ardhurave vendore.
- Të ardhurat nga taksat vendore kanë patur një trend rritës krahasuar me çdo vit paraardhës, përkatësisht **28%** në vitin 2016, **23%** në vitin 2017, **19%** në vitin 2018, **6%** në vitin 2019 dhe **1%** në vitin 2020.
- Gjatë vitit 2020, pavarësisht ngadalësimit të produktit të brendshëm bruto si pasojë e pandemisë COVID-19, është ruajtur një vlerë e përafërt e transfertës së pakushtëzuar të pushtetit vendor prej **17.2 miliard lekë**.
- Efekti i pandemisë COVID-19 dhe ngadalësimi ekonomik gjatë vitit 2020 reflektohet në rënien e disa prej burimeve të rëndësishëm për financimin e buxhetit vendor. Gjatë vitit 2020 në raport me vitin 2019, konstatohet një rënie me rreth **500 milion lekë** i të ardhurave vendore nga “Taksa e ndikimit në infrastrukturë” ose **6%**, gjithashtu rënie me **150 milion lekë** nga “Tarifa e zënies së hapësirës publike” ose ndryshe me një **20%**, si edhe rënie rreth **270 milion lekë** të të ardhurave jotatimore e thënë ndryshe rreth **10% më pak**.
- “Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja” zë peshën më të madhe të të ardhurave vendore në rreth **37% të totalit të të ardhurave**. Rreth **18% të totalit të të ardhurave vendore** e zë “taksa mbi ndërtesën” dhe pas saj të ardhurat nga “tarifa e pastrimit dhe higjenës” me rreth **17%**.
- Rreth **80%** të totalit të të ardhurave nga “taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja” gjatë vitit 2020 e arkëtoi Bashkia Tiranë, ku në vlerë absolute nga **7.9 miliard lekë**

**që arkëton i gjithë pushtetit vendor për këtë burim, 6.3 miliard lekë** i përkasin kësaj njësie. Totali i kësaj takse të mbledhur nga bashkitë e tjera është vetëm **11%** e totalit të të ardhurave vendore.

- Rreth **30 njësi** të vetëqeverisjes vendore gjatë vitit 2020 kanë patur një rënie të të ardhurave të veta vendore në raport me një vit më parë. Normën më të lartë të rënies me rreth 61% me pak të ardhura e ka bashkia Libohovë, e ndjekur nga bashkia Lezhë me 57% dhe bashkia Kamëz me 37%.
- Gjysma tjetër e njësive të vetëqeverisjes vendore gjatë vitit 2020 kanë patur rritje në norma të ndryshme të të ardhurave, ku normën më të lartë të rritjes e ka bashkia Pukë me 93% më shumë të ardhura dhe pas saj bashkia Kukës me 36% më shumë të ardhura krahasuar me vitin 2019.<sup>1</sup>
- **Bashkia Tiranë** zë vendin e parë sa i përket shumës së mbledhur të të ardhurave të veta me **13,888,776 mijë lekë**, shumë e cila përbën **57.4 %** të totalit të të ardhurave të mbledhura nga të gjitha bashkitë. Bashkia Tiranë gjatë vitit 2020 ka arritur të arkëtojë rreth 21,744 lekë për banor. Nëse nga totali i të ardhurave të bashkisë Tiranë do të përjashtonim “taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja” prej 6.3 miliard lekë, atëherë pesha e të ardhurave të bashkisë Tiranë ndaj totalit të të ardhurave të pushtetit vendor do të jetë në kuotën e **42%**.
- Bashkia Durrës renditet në vendin e dytë me **921,459 mijë lekë**, e cila përbën **3.81 %** të totalit të të ardhurave të mbledhura nga të gjitha bashkitë. Pavarësisht që bashkia Durrës renditet si bashkia e dytë në raport me të ardhurat totale të arkëtuara, në raport me numrin e popullsisë ajo ka arkëtuar vetëm **4,196 lekë** për banor.
- Në vendin e tretë renditet bashkia Elbasan, për të vijuar me bashkitë Vlorë, Shkodër, Fier dhe Korçë, të cilat kanë arkëtuar mbi **500,000 mijë lekë** të ardhura secila ose ndryshe nga rreth **3%** të totalit të të ardhurave vendore.
- Bashkitë të cilat kanë një popullsi më shumë se **100 mijë banorë** (10 bashki, pa përfshirë bashkinë Tiranë), kanë arkëtuar gjatë vitit 2020 në total rreth **5.5 miliard lekë** ose ndryshe rreth **25%** e totalit të të ardhurave të pushtetit vendor. Krahasuar me një vit më parë ku kanë arkëtuar rreth **6.6 miliard lekë**, ky grup i njësive të vetëqeverisjes vendore gjatë vitit 2020 ka pësuar një rënie të të ardhurave me rreth **1.1 miliard lekë** ose **16%**.
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore me një popullsi nga **50 mijë deri në 100 mije banorë** (13 bashki) gjatë vitit 2020 kanë arkëtuar vetëm **2 miliard lekë** ose ndryshe rreth **9%** e totalit të të ardhurave të pushtetit vendor. Krahasuar me një vit më parë ku ky grup i njësive ka arkëtuar rreth **2.2 miliard lekë**, të ardhurat e këtij grupi kanë rënë me rreth **200 milion lekë** ose **9.1%**.
- Bashkitë me një popullsi **nën 50,000 banorë** (37 bashki) kanë arkëtuar rreth **2.6 miliard lekë** ose rreth **11.8%** e totalit të të ardhurave të pushtetit vendor. Krahasuar me një vit më parë ku ky grup i bashkive ka arkëtuar rreth **2.7 miliard lekë**, të ardhurat në vitin 2020 kanë pësuar një rënie në afërsisht **100 milion lekë** ose **3.7%**.
- Gjatë vitit 2020, 19 bashki (Kolonjë, Skrapar, Mirditë, Bulqizë, Kurbin, Konispol, Pukë, Përmet, Delvinë, Tropojë, Tepelenë, Poliçan, Klos, Fushë-Arrëz, Has, Memaliaj, Këlcyrë, Libohovë, Pustec) ose ndryshe **31%** e totalit të bashkive, paraqiten me të ardhura në shumën **4,000 – 50,000 mijë lekë**.

1. Për bashkinë Pukë rritjen më të madhe e ka patur taksa e pasurise, ndërkohe që bashkia Kukës rritjen me të madhe e ka në zërin taksa të tjera në të cilën regjistrohen të ardhura që arkëtohen në një moment të vetëm dhe nuk përbën të ardhur të qëndrueshme për këtë NJVQV.

- 17 bashki (Mallakastër, Devoll, Cërrik, Kuçovë, Maliq, Divjakë, Dibër, Vau i Dejës, Mat, Malësi e Madhe, Selenicë, Belsh, Finiq, Prrenjas, Gramsh, Dropull, Peqin) ose ndryshe rreth **27%** e totalit të bashkive, paraqiten me të ardhura në shumën **50,000 – 100,000 mijë lekë**.
- 18 bashki (Kamëz, Sarandë, Lushnje, Himarë, Kavajë, Berat, Lezhë, Vorë, Pogradec, Krujë, Patos, Roskovec, Kukës, Gjirokastër, Shijak, Ura Vajgurore, Librazhd, Rrogozhinë) rreth **29.5%** e totalit të bashkive kanë realizuar të ardhura në shumën **100,000 – 500,000 mijë lekë**.
- Vetëm **7 bashki** (Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Shkodër, Fier, Korçë rezultojnë me të ardhura në shumën mbi **500,000 mijë lekë**.
- Përsa i përket të ardhurave të mbledhura nga **Këshillat e Qarqeve**, qarku Lezhë zë vendin e parë me **6,970 mijë lekë**, i cili përbën **52.9 %** të të ardhurave të mbledhura total nga qarqet. Në vendin e dytë renditet qarku Elbasan me **2,629 mijë lekë** të ardhura, i cili përbën **20 %** të të ardhurave totale të mbledhura nga qarqet. Më pas renditet qarku Shkodër, ku të ardhurat e mbledhura në renditje janë më pak se **1,000 mijë lekë**, ndërkohë të ardhurat e secilit prej qarqeve, përbëjnë më pak se **10 %** në raport me totalin.

Gjatë vitit 2020, pushteti vendor gjithashtu është ndikuar ndjeshëm në realizimin e shpenzimeve për shkak pandemisë. Ndryshime kanë pësuar jo vetëm shpenzimet sipas natyrës ekonomike por gjithashtu edhe ato në nivel funksioni e njësie të vetëqeverisjes vendore. Si më poshtë, disa nga efektet bazë në treguesit fiskal të pushtetit vendor:

- Pushteti vendor gjatë vitit 2020, ka realizuar rreth **51.6 miliard lekë** shpenzime për financimin e funksioneve ose rreth **8% më pak** se shpenzimet e realizuara gjatë vitit 2019.
- Këto shpenzime kanë realizuar rreth **97% e planit vjetor prej 53.2 miliard lekë**, duke rezultuar me një nivel të kënaqshëm pavarësisht situatës pandemike dhe tërmetit të nëntorit 2019.
- I njëjti trend realizimi me të ardhurat nga burimet e veta gjatë periudhës së mbylljes ekonomike të 6 mujorit të parë 2020 është ruajtur edhe në shpenzimet e pushtetit vendor, duke u realizuar vetëm **17 miliard lekë ose vetëm 32%** e totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor prej **51.6 miliard lekë**.
- Shpenzimet e pushtetit vendor pas reformës administrativo-territoriale pavarësisht trendit rritës prej **28%** në vitin 2016 krahasuar me një vit më parë, apo **7%** në vitin 2017 dhe 2018, **13%** në vitin 2019, viti 2020 ka pësuar një rënie të shpenzimeve vendore me rreth **8%**.
- Nga analiza e shpenzimeve sipas llogarive ekonomike konstatohet që peshën më të madhe të këtyre shpenzimeve gjatë vitit 2020 e zënë shpenzimet për paga dhe sigurime ose ndryshë rreth **43%** të totalit të shpenzimeve vendore dhe pas tyre shpenzimet operative të cilat zënë **29%** dhe në fund shpenzimet kapitale me rreth **25%**.
- Në raport me një vit më parë gjatë vitit 2020 shpenzimet për investime kanë një rënie me rreth **5 miliard lekë** ose rreth **28%** më pak krahasuar me vitin 2019, kjo si pasojë e rialokimeve për përballimin e pandemisë COVID-19 por edhe shtyerjes së shumë procedurave të prokurimit. Ndërkohë që shpenzimet e personelit kanë një rritje të lehtë përkatësisht me **555 milion lekë** dhe ato operative **202 milion lekë** krahasuar me shpenzimet e vitit 2019.
- Nga **51.6 miliard lekë** që janë shpenzimet vendore gjatë vitit 2020, rreth **51% ose 26.1 miliard lekë** e zënë shpenzimet me burim transfertat e buxhetit qendror, ndërkohë pjesa



tjetër e këtyre shpenzimeve mbulohet nga të ardhurat e veta të pushtetit vendor dhe taksat e ndara. Krahasuar me një vit më parë, kanë pësuar rënie shpenzimet e pushtetit vendor me burim financimi të ardhurat e veta vendore me rreth **2 miliard lekë** ose **7%** më pak, e njëjta rënie me rreth **2 miliard lekë** gjithashtu kanë pësuar shpenzimet me burim financimi transfertat e pushtetit qendror.

- Gjatë vitit 2020, pushteti vendor ka financuar në pjesën më të madhe të shpenzimeve funksionet e “Shërbimeve të përgjithshme publike” dhe “Arsimit”, përkatësisht në masën **22% dhe 20%** të totalit të shpenzimeve vendore.
- Shpenzimet për “Shërbime të Përgjithshme Publike” patën rënie me **0.5%**, “Strehimi dhe komoditetet e komunitetit” me **19%** më pak apo funksioni i “Mbrotjes Sociale” me **32.7%** ulje.
- Rritje të shpenzimeve në vitin 2020 në raport me një vit më parë kanë ndodhur në funksionet e “Mbrotjes së mjedisit” me **109%** apo “Çështjet ekonomike” me **28%** si rrjedhim i politikave vendore që lidhen me pastrimin e gjelbërimin gjatë pandemisë dhe asistencës së drejtpërdrejtë për ringritjen ekonomike.
- Gjithashtu, në politikat vendore të vitit 2020 konstatohet rritja e vëmendjes ndaj funksionit të “Shëndetësisë” i cili shoqërohet me rritje të shpenzimeve për këtë funksion me rreth **12.5%** më shumë se në vitin 2019.
- Rreth **39 bashki** nga totali i njësive të vetëqeverisjes vendore kanë patur një rënie të shpenzimeve në vitin 2020 në raport me shpenzimet e realizuara në vitin 2019. Bashkitë që kanë patur rënien më të madhe janë bashkitë me një peshë të vogël në raport me totalin e shpenzimeve të pushtetit vendor si bashkia Vorë me një rënie prej **44%**, bashkia Vau Dejës me **38%** apo bashkia Kamëz me rreth **23%** rënie të shpenzimeve.
- Pjesa e mbetur prej 22 bashkive kanë patur rritje të shpenzimeve në vitin 2020 në raport me vitin 2019. Bashkitë të cilat kanë patur rritjen më të madhe të shpenzimeve gjatë vitit 2020 janë gjithashtu bashki të vogla, si bashkia Rrogozhinë me një rritje prej **48%** apo bashkia Prrenjas me **27%** rritje në raport me vitin 2019.<sup>2</sup>
- Për rindërtimin nga tërmeti në nivel vendor, nga fondi i planifikuar prej **29 miliardë lekësh** nga shpenzimet e buxhetit, për vitin 2020 janë akorduar **14,9 miliardë lekë** në formën e trasfertës së pakushtëzuar për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, të cilat janë realizuar në masën **56 për qind**, ose **8.3 miliardë lekë**.
- Bashkia Tiranë me një realizim prej **18.2 miliard lekë** shpenzime gjatë vitit 2020, zë peshën e **35.7%** të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor.
- Analiza e bashkive sipas popullsisë konstaton që **10 bashkitë** me popullsi mbi 100 mijë banorë (pa përfshirë bashkinë Tiranë) kanë realizuar rreth **14.1 miliard lekë** shpenzime gjatë vitit 2020 ose ndryshe rreth **27.8%** të totalit të shpenzimeve vendore.
- Pjesa tjetër prej **13 njësi** bashki që kanë popullsi ndërmjet 50 mijë dhe 100 mijë banorë, kanë realizuar gjatë vitit 2020 rreth **7.3 miliard lekë** ose ndryshe rreth **14%** të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor.
- Pjesa më e konsiderueshme e totalit të bashkive, saktësisht **37 bashki** që kanë popullsi me më pak se 50 mijë banorë kanë realizuar gjatë vitit 2020 rreth **10.8 miliard lekë** shpenzime ose ndryshe rreth **21.3%** të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor.

2. Keto dy njësi të vetëqeverisjes vendore, përmes ligjit vjetor të buxhetit nr. 88, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020” kanë përfituar një shtesë fondi për investime, e cila zë një peshë të konsiderueshme të buxhetit që ka rritur në këtë mënyrë edhe raportin e shpenzimeve krahasuar me një vit më parë.

- Analiza e shpenzimeve për banorë gjatë vitit 2020 konstaton që vlerën më të lartë të këtyre shpenzimeve e ka Bashkia Tiranë me rreth **21,726 lekë për banor** ndërkohë që pas asaj vjen bashkia Skrapar me rreth **19,644 lekë** për banor. Bashkitë me vlerën më të vogël të shpenzimeve për banor janë bashkia Kurbin me rreth **5,545 lekë** për banor dhe bashkia Kuçovë me **6,721 lekë** për banor.
- Stoku i detyrimeve të prapambetura për njësitë e vetëqeverisjes vendore në fund të muajit dhjetor 2020, i cili parashikohet të shlyhet në një periudhë afatmesme është rreth **6.9 miliard lekë**. Vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura është ulur me **1.2 miliard lekë** krahasuar me stokun e detyrimit në fund të vitit 2019, që ishte **8.1 miliard lekë**.
- Detyrimet e prapambetura të klasifikuara sipas kategorive, peshën më të madhe të stokut e zë kategoria “Investime” me **54.4%**, kategoria “Të tjera” **17.3%**, “Shërbime” **10.3%**, dhe “Vendime Gjyqësore” **10%**.
- Nga fondi i planifikuar prej **29 miliardë lekësh** nga shpenzimet e buxhetit, për vitin 2020 janë akorduar **14,9 miliardë lekë** në formën e transfertës së pakushtëzuar për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, të cilat janë realizuar në masën **56%** ose **8.3 miliard lekë**.

Kjo përmbledhje e mësipërme do të vijë në ndihmë orientimit të saktë të analizës së treguesve të pushtetit vendor për vitin 2020. Treguesit fiskalë të paraqitur në mënyrë të përmbledhur do të detajohen në vazhdim për secilin burim të të ardhurave apo natyre të shpenzimeve vendore.



# 1. Hyrje mbi raportin e realizimit të buxhetit vendor 2020

Reforma në modernizimin e menaxhimit të financave publike në nivel vendor është një proces i iniciuar tashmë prej disa vitesh, e cila një dimension të ri zhvillimi e mori pas reformës administrativo-territoriale. Ministria e Financave dhe Ekonomisë prodhon këtë raport zyrtar mbi realizimin e buxhetit vendor si një formë për të prezantuar jo vetëm treguesit sasior por gjithashtu edhe për të përshkruar të gjitha proceset që kanë ndikuar në këtë ecuri. Krijimi i njësisve të reja të vetëqeverisjes vendore me një shtrirje të gjërë territoriale, nxiti zhvillimin e kapaciteteve njerëzore që do ti jepnin një ritëm tjetër zhvillimit, mes të cilit edhe menaxhimit financiar publik. Gjatë këtyre viteve nga publikime të ndryshme janë evidentuar dobësi të theksuara në mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave, në kryerjen me efencë të shpenzimeve, në mbajtjen e kontabilitetit publik duke u reflektuar në këtë mënyrë në shërbime publike me një efencë të ulët. Në këtë kontekst, u miratuan disa dokumenta strategjikë dhe plane veprimi që synonin konsolidimin fiskal të 61 njësisve të vetëqeverisjes vendore dhe implementimin e metodologjive të cilët do i japin ritmin e duhur menaxhimit të financave në nivel vendor. Ecuria pozitive e miratimit të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe akteve nënligjore, u pasua nga procese shumë të ngushta implementimi të tyre nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në të gjitha NJVQV-të.

Unifikimi i proceseve të menaxhimit të financave publike në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, unifikimi metodologjive me ato të implementuara në nivel qendror dhe plotësimi i të gjitha kërkesave ligjore, janë disa nga objektivat kryesore të realizuara gjatë vitit 2020 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në drejtim të konsolidimit financiar në nivel vendor. Në këto kushte, gjatë vitit 2020 objektivat e strukturës përgjegjëse për menaxhimin financiar në nivel vendor kanë synuar implementimin në 73 NJVQV-ve të akteve nënligjore për hartimin e programit buxhetor afatmesëm, monitorimin e zbatimit të buxhetit dhe analizën e vështirësive financiare. Gjithashtu, ndjekja me kujdes e vështirësive të krijuara në menaxhimin financiar vendor nga pandemia COVID-19 si në drejtim të të ardhurave nga burimet e veta ashtu edhe në rialokimet mes programeve buxhetore për të financuar shërbimet jetike, ishte një fokus i veçantë gjatë vitit 2020. Disa prej arritjeve më të rëndësishme në proceset e menaxhimit të financave vendore gjatë vitit 2020, paraqiten si më poshtë:

- Implementimi i metodologjisë për hartimin e programit buxhetor afatmesëm në nivel produkti buxhetor, përmes formateve të reja të miratuara në udhëzimin vjetor;
- Asistenca e drejtpërdrejtë ndaj NJVQV-ve me rishikimin e kalendarit të afateve të hartimit të programit buxhetor afatmesëm 2020-2022, si pasojë e anulimit të fazës së parë nga pandemia COVID-19;
- Rishikimi i udhëzimeve vjetore për përgatitjen e buxhetit vendor në përputhje me nevojat për informacion që kanë NJVQV-të në secilën fazë të përgatitjes së PBA-së dhe problematikave të paraqitura nga proceset e konsultimit;
- Përfundimi i raportit të parë zyrtar për menaxhimin e vështirësive financiare, ku identifikohet situata e gjendjes financiare të 61 njësisve të vetëqeverisjes vendore;

- Mbështetja e të gjitha NJVQV-ve me asistencë direkte nga personeli i MFE në procesin e rishpërndarjeve buxhetore të imponuara nga ndryshimi i prioriteteve strategjike si pasojë e pandemisë COVID-19 dhe rindërtimit nga tërmeti;
- Zhvillimi i seancave periodike dëgjimore dhe konsultative me njësitë e vetëqeverisjes vendore në funksion të rishpërndarjeve buxhetore sipas nevojave të identifikuar pas vështirësive në mbledhjen e të ardhurave nga taksat vendore në 6 mujorin e parë 2020;
- Plotësimi i pjesës së mbetur të kuadrit nënligjor për hartimin e monitorimin e menaxhimit financiar në nivel vendor;
- Mbikqyrja e procesit të implementimit të procedurave të qarta të zbatimit të buxhetit vendor për të gjitha shpenzimet nga të ardhurat e veta vendore dhe gjithashtu për transfertat nga buxheti qendror;
- Monitorimi i vazhdueshëm i treguesve fiskalë të zbatimit të buxhetit 2020, në funksion të implementimit të atyre politikave buxhetore që do të rrisin eficiencën dhe efektivitetin e përdorimit të fondeve publike në nivel vendor.

Implementimi i kujdesshëm i të gjitha këtyre masave nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë vitit 2020 janë një tregues i rëndësishëm për rritjen e autonomisë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe për rrjedhojë rritjen e cilësisë së shërbimeve të rëndësishme për jetën e qytetarëve. Përballimi i një sfide të madhe ekonomike dhe buxhetore nga njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë vitit 2020, janë një tregues pozitiv i punës së zhvilluar në këto vite në drejtim të stabilitetit makroekonomik, parashikueshmërisë së fondeve dhe transparencës së përdorimit me disiplinë të fondeve buxhetore.

Në këndvështrimin metodologjik, përmes këtij Raporti Vjetor të Zbatimit të Buxhetit Vendor 2020 synohet të paraqitet një analizë e detajuar e tendencave dhe situatës financiare të pushtetit vendor por edhe në nivel njësie sipas 61 Bashkive dhe 12 Këshillave të Qarqeve. Kjo analizë ka për qëllim të evidentojë në mënyrë thelbësore burimet e financimit të NJVQV-ve, shpenzimet për ushtrimin e funksioneve dhe efektivitetin e përdorimit të burimeve financiare për vitin 2020 por edhe në raport me vitet e tjera krahasimore. Në kushtet kur viti 2020, është një vit jo i zakonshëm për financat publike në tërësi dhe ato vendore në veçanti, si pasojë e pandemisë COVID-19 dhe tërmetit të nëntorit 2019, një pjesë të rëndësishme të analizës do ta zënë këto tregues dhe ndikimi i tyre në politikën e zhvillimit vendor. Një hapësirë të rëndësishme në këtë raport zë analiza krahasimore, niveli i implementimit të reformave në nivel vendor deri në vitin 2020 dhe objektivat që priten të zbatohen gjatë vitit 2021.

Kjo analizë është bazuar mbi të dhënat zyrtare të përpunuara nga Drejtoria e Financave Vendore për 61 Bashki dhe 12 Këshillat e Qarkut në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (Sistemi i Thesarit SIFQ), informacioni zyrtar mbi buxhetet vendore i përcjellë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe nga INSTAT. Këto të dhëna janë përpunuar nga grupi i punës në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë së bashku me asistencën e Projektit “Financat Lokale” të financuar nga Ambasada Zvicerane. Në funksion të analizave për numrin e popullsisë është përdorur treguesi sipas përcaktimeve të formulës së transfertës së pakushtëzuar në formën e banorëve rezidentë efektivë<sup>3</sup>.

Në analizën në tërësi të qeverisjes vendore, treguesit fiskal janë paraqitur në përputhje me metodologjinë kombëtare të raportimit, duke mos përfshirë të dhënat nga transfertat e kushtëzuara që merr pushtetit vendor nga Ministrinë e Linjës.

3. Banorë rezidentë efektivë = [CENSUS + (Regjistri i gjendjes civile - Census) \* 30%]

Për të dhënë një pamje të plotë, raporti ofron krahasime të të ardhurave dhe shpenzimeve në terma vjetor, dhe prezanton disa konkluzione mbi tendencat e financave vendore ndër vite, jo vetëm brenda njësive të vetëqeverisjes vendore. Pjesë e analizës janë arritjet e vitit 2020 në drejtim të menaxhimit financiar vendor dhe evidentime konkrete të zbatimit të buxhetit për secilën njësi të vetëqeverisjes vendore. Nga pikëpamja metodologjike, krahasimi me të dhënat faktike të viteve të mëparshme bëhet duke iu referuar 73 njësive të vetëqeverisjes vendore dhe mundëson nxjerrjen e disa konkluzioneve paraprake mbi përmirësimet e sjella nga reforma administrative territoriale në eficiencën operacionale të njësive të vetëqeverisjes vendore ndër vite, por veçanërisht në vitin 2020. Me qëllim prezantimin e një analize në shumë dimensione, treguesit fiskalë të pushtetit vendor janë vendosur në raport me disa tregues makroekonomikë që paraqesin nivelin e zhvillimit.

Ky raport mbi zbatimin e financave vendore 2020, është vazhdimësi e raporteve vjetore të publikuara në vitet 2019 dhe 2018 edhe të analizave integrale mbi ecurinë e financave publike pjesë e rëndësishme e të cilës janë dhe financat vendore.

## 2. Ecuria e implementimit të proceseve të menaxhimit të financave vendore gjatë vitit 2020.

Gjatë vitit buxhetor 2020, e gjithë ekonomia është ndeshur me një sërë sfidash për tu menaxhuar, nga ku nuk bën përjashtim menaxhimi i financave publike në tërësi por dhe menaxhimi i financave në nivel vendor në veçanti. Shumë parashikime optimiste në treguesit e performancës që priteshin nga menaxhimi i financave vendore ndryshuan në gjysmën e parë të këtij viti si pasojë e situatës së vështirë ekonomike të krijuar nga pandemia Covid-19. Si rrjedhim, norma e ecurisë së implementimit të reformave në financat vendore iu nënshtrua një rishikimi të thelluar. Nga ana tjetër njësitë e vetëqeverisjes vendore të detyruara nga situata rishikuan ndjeshëm treguesit fiskalë duke krijuar lehtësira fiskale apo shtyrë në kohë pritshmëritë për arkëtim të të ardhurave të parashikuara në fillim të vitit. Ky ndryshim preku të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, pavarësisht nga potenciali fiskal që këto njësi kishin para fillimit të pandemisë. Shtyrja e afateve në akumulimin e të ardhurave sigurisht që u shoqërua me rishpërndarje të fondeve buxhetore, në dispozicion të atyre shërbimeve që konsiderohen të domosdoshme për jetën e qytetarëve. Miratimi i aktit normativ nr. 17, datë 22.04.2020 "Për përjashtimin e zbatimit të procedurave dhe të afateve për përgatitjen e projektdokumentit të programit buxhetor afatmesëm për vitin 2020", bëri që faza e parë e hartimit të programit buxhetor afatmesëm të mos zhvillohej për të shmangur procesin e grumbullimit të personave në diskutime. Ky ndryshim ndikoi disa procese të hartimit të programit buxhetor afatmesëm por nuk kufizoi që faza e dytë të zhvillohet e plotë dhe në përputhje me përcaktimet e udhëzimeve vjetore.

Si pasojë e pandemisë shumë procese në fillim të vitit 2020 mbeten pezull dhe sigurisht të gjitha parashikimet makroekonomike mbi treguesit fiskal të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore u përmbysën duke vështirësuar realizimin e tyre. Në këtë këndvështrim, gjatë vitit 2020 disa nga problematikat kryesore që u shkaktuan nga pandemia COVID-19 në drejtim të proceseve të menaxhimit të financave vendore janë si më poshtë vijon:

1. Anullimi i fazës së parë të PBA-së;

Ndalimi i grumbullimeve dhe i kontakteve fizike ndryshoi proceset e hartimit të programit buxhetor afatmesëm. Si pasojë e masave të jashtëzakonshme të ndërmarra për shkak të pandemisë procesi i hartimit të kërkesave buxhetore për vitin 2021-2023 u shty në fazën e parë që ndryshe konsiderohet edhe faza strategjike. Shtyrja e kësaj faze, ishte një proces që ndodhi për herë të parë që nga momenti i implementimit të tij, duke sjellë shumë pasiguri kryesisht lidhur me mënyrën si do të procedohej me fazat e tjera. Në këtë drejtim, Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes udhëzimit vjetor plotësues, si dhe hartimit të programit buxhetor afatmesëm ndërhyri duke miratuar orientimet e nevojshme lidhur me proceset e kalendarin që duhet të ndjekin njësitë e vetëqeverisjes vendore.

2. Ndryshimi i prioriteteve të financimit të shërbimeve publike;

Rënia e ndjeshme e të ardhurave si pasojë e pandemisë dhe ndryshimi i ciklit të mbledhjes së tyre bëri që shumë shërbime vendore të vendosen në vështirësi për tu mbuluar sipas planit

vjetor të miratuar. Kjo situatë emergjente solli mjaft ndryshime në raport me planin fillestar të miratuar për financimin e shërbimeve publike. Shumë shërbime publike të cilat nuk kishin zënë një peshë të madhe para situatës së krijuar nga pandemia, patën një vëmendje dhe prioritet të veçantë të tilla si “Pastrimi dhe dizinfektimi” dhe “Shëndetësia”.

3. Përfshirja e koncepteve bazë të hartimit të programit buxhetor afatmesëm në nivel produkti;

Gjatë vitit 2020, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ndërmori një hap shumë të rëndësishëm përmes miratimit të një sërë formatesh për hartimin e programit buxhetor afatmesëm në nivel produkti buxhetor. Përfshirja e këtij koncepti ishte fillimi i një procesi të rëndësishëm të realizimit të plotë të metodologjisë së përcaktuar në ligjin nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

4. Krijimi i formateve të reja të hartimit të PBA-së dhe përfshirja në udhëzimet vjetore i formateve të njëjtja me ato në nivel qendror;

Unifikimi i plotë i metodologjive në nivel qendror dhe vendor, gjatë vitit 2020, ishte një proces i domosdoshëm në funksion të arritjes së objektivit afatmesëm sic është shtrirja e AFMIS në nivel vendor. Inicimi i këtij procesi përmes formateve të reja të unifikuara me buxhetin qendror është një fazë mjaft e rëndësishme për pushtetin vendor, në përmbylljen përfundimtare të metodologjisë për hartimin e programit buxhetor afatmesëm.

5. Bashkëpunimi i vazhdueshëm në orientimin e rishpërndarjeve buxhetore në funksion të shërbimeve bazë për qytetarët;

Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë viti 2020 ka patur në fokus asistencën e vazhdueshme ndaj njësive të vetëqeverisjes vendore në drejtim të menaxhimit financiar me qëllim tejkalimin e vështirësive të akumuluar nga situata e krijuar nga pandemia. Këto rishpërndarje buxhetore u orientuan nga MFE në pakësimin e fondeve të atyre shërbimeve të planifikuara por që nuk përbëjnë emergjencë dhe financimin e shërbimeve bazë gjatë periudhës pandemike si pastrimi e dizinfektimi, shëndetësia etj.

6. Mbështetja financiare përmes shpërndarjes së Tatimit mbi të Ardhurat Personale për njësitë e vetëqeverisjes vendore;

Gjatë vitit 2020, u ndërmorën masat e nevojshme për zbutjen e problematikave financiare të shkaktuara nga mungesa e të ardhurave si pasojë e situatës problematike ekonomike, nëpërmjet shpërndarjes së Tatimit mbi të Ardhurat Personale. Shpërndarja e plotë e këtij burimi i dha mundësi njësive të vetëqeverisjes vendore për të amortizuar ndjeshëm vështirësitë e krijuara.

7. Mbështetja buxhetore për shërbimet bazë si arsimit, shëndetësia apo emergjencat civile të cilat kanë qënë në funksion të pandemisë COVID-19;


Shumë nga ndryshimet buxhetore të vitit 2020, u orientuan në funksion të mbulimit të disa nga shërbimeve bazë për qytetarët, gjithashtu rialokime buxhetore të cilat i shërbejnë incentivave ekonomike nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore. Disa shërbime publike pësuan një bllokim për shkak të pamundësisë për tu financiar menjëherë, për arsye se fokus dhe vëmendje e veçanti ju kushtua më së shumti financimit të shëndetësisë apo arsimit. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për këto shërbime gjatë vitit 2020 ka dhënë vazhdimisht rekomandime që rialokimet buxhetore të ndihmonin në rritjen e kapaciteteve të këtyre sektorëve dhe tejkalimit të vështirësive.

### 3. Analiza e treguesve të përgjithshëm të buxhetit vendor 2020.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pjesë të manualeve bazë të monitorimit të treguesve fiskalë ka edhe ecurinë e të ardhurave dhe shpenzimeve të pushtetit vendor në përputhje me parashikimet makroekonomike. Analiza e detajuar makroekonomike e treguesve të pushtetit vendor do të paraqesë peshën që ky pushtet ka në shërbimet publike dhe zhvillimin e ekonomisë në tërësi. Situata financiare e njësive të vetëqeverisjes vendore pjesë e kësaj analize përfshin jo vetëm të ardhurat dhe shpenzimet por gjithashtu dhe detyrimet e prapambetura, duke zhvilluar në këtë mënyrë një analizë komplekse financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Gjatë vitit 2020, pushteti vendor ka realizuar të ardhura të veta tatimore dhe jotatimore rreth 24.2 miliard lekë ose ndryshe rreth 1.4 miliard lekë më pak se realizimi i të ardhurave gjatë vitit 2019. Nga të këto të ardhura, gjatë vitit 2020 rreth 2.2 miliard lekë janë të ardhura jotatimore dhe pjesa tjetër prej 21.9 miliard lekë janë të ardhura tatimore të pushtetit vendor. Duke marrë në analizë këto të ardhura evidentojmë që janë realizuar rreth 95% e planit vjetor 2020, pra rreth 23 miliard lekë. Nga ana tjetër, pushteti vendor gjatë vitit 2020, ka realizuar rreth 51.6 miliard lekë shpenzime për financimin e funksioneve. Këto shpenzime janë realizuar rreth 97% e planit vjetor prej 53.2 miliard lekë, duke rezultuar me një nivel të kënaqshëm pavarësisht situatës pandemike dhe tërmetit të nëntorit 2019. Treguesit e planifikuar dhe të realizuar të të ardhurave dhe shpenzimeve të pushtetit vendor gjatë vitit 2020 paraqiten si në grafikun më poshtë:


**Grafiku 1: Plan/Fakt i të ardhurave dhe shpenzimeve të pushtetit vendor gjatë vitit 2020**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

Pushtetit vendor gjatë vitit 2020, në muaj të ndryshëm ka patur luhatje në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve duke krijuar në shumë raste disbalanca të cilat janë mbuluar nga përdorimi i burimeve të tjera si transfertat e buxhetit qendror. Shpërndarja e realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve sipas muajve është realizuar sipas grafikut të mëposhtëm:

**Grafiku 2: Realizimi mujor i të ardhurave dhe shpenzimeve të pushtetit vendor 2020.**




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

Analiza e trendit të treguesve të mësipërm lidhet plotësisht me efektete e situatës së krijuar nga pandemia që përjetoi ekonomia në tërësi dhe sigurisht buxheti i njësisve të vetëqeverisjes vendore. Në 6 mujorin e parë të vitit 2020, pushteti vendor ka realizuar një nivel mjaft të ulët të të ardhurave, ndërkohë që shpenzimet vendore kanë ruajtur gjithashtu një trend të kufizuar si pasojë e kurrjes ekonomike në tërësi. Për sa më sipër, pushteti vendor ka mbledhur rreth 7 miliard lekë ose vetëm 32% të totalit të të ardhurave vjetore prej 21.9 miliard lekë. I njëjti trend realizimi gjatë periudhës së mbylljes ekonomike të 6 mujorit të parë është ruajtur edhe në shpenzimet e pushtetit vendor, duke u realizuar vetëm 17 miliard lekë ose vetëm 32% e totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor prej 51.6 miliard lekë.

Tejkalimi i situatës pandemike dhe hapja e ekonomisë bëri që trendi i treguesve të pushtetit vendor të ndryshojë duke nisur një rikuperim me ritëm të lartë. Gjatë pjesës së dytë të vitit u realizuan rreth 14.9 miliard lekë të ardhura nga pushteti vendor dhe gjithashtu 34.7 miliard lekë shpenzime nga të gjitha burimet vendore. Rritja e besimit në rikthimin e ekonomisë në normalitet bëri që të dyfishohen shpenzimet mujore të pushtetit vendor në tërësi. Gjithashtu, pasojë e akumulimit të shumë shpenzimeve gjatë 6 mujorit të parë 2020, u reflektua në realizimin e vlerës më të madhe të shpenzimeve më rreth 7 miliard lekë në muajin korrik. Ndërkohë që vlerën më të lartë të të ardhurave mujore pushteti vendor e ka realizuar në muajin Qershor me rreth 3.2 miliard lekë.



**Grafiku 3: Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve në vitin 2020 dhe vitin 2015.**


Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

Reforma administrativo-territoriale dha një efekt të konsiderueshëm në potencialin fiskal të pushtetit vendor, duke rritur jo vetëm kapacitetet për mbledhjen e të ardhurave të veta vendore por gjithashtu edhe në rritjen e shpenzimeve për shërbimet vendore. Të ardhurat nga taksat vendore kanë patur një trend rritës krahasuar me çdo vit paraardhës, përkatësisht 28% në vitin 2016, 23% në vitin 2017, 19% në vitin 2018, 6% në vitin 2019 dhe 1% në vitin 2020. Nga ana tjetër shpenzimet e pushtetit vendor pas reformës administrativo-territoriale pavarësisht trendit rritës prej 28% në vitin 2016 krahasuar me një vit më parë, apo 7% në vitin 2017 dhe 2018, 13% në vitin 2019, viti 2020 ka pësuar një rënie të shpenzimeve vendore me rreth 8%. Kjo rritje është konsiderueshme në kapacitetin fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore, ishte një provë e rëndësishme mbi rëndësinë që mori reforma në menaxhimin financiar publik të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Rritja e rolit të pushtetit vendor në drejtim të shërbimeve publike dhe funksioneve që ushtron, ka bërë që raporti i të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave publike dhe produktit të brendshëm bruto të ndryshojë me rritje në vitet e fundit. Të ardhurat e pushtetit vendor, pavarësisht rënies në vlerë absolute gjatë vitit 2020 si pasojë e rënies ekonomike në tërësi nga pandemia, në raport me të ardhurat publike janë rritur nga 5.02% në vitin 2019 në 5.16% në vitin 2020. Nga viti 2015, ku raport i të ardhurave vendore me të ardhurat publike ishte rreth 3.09%, rritja e rolit dhe fuqisë fiskale të pushtetit vendor në vitin 2020 u shoqërua me rritje të këtij raporti me rreth 2.07%. Nga ana tjetër, pushteti vendor ka rritur rolin e tij në vite përmes kontributit në ekonomi e në Produktin e Brendshëm Bruto duke ndryshuar raportin nga 0.82% e PBB në vitin 2015 në 1.51% në vitin 2020, me një rritje prej 0.58% e PBB-së.




**Grafiku 4: Të ardhurat vendore në raport me totalin e të ardhurave publike dhe PBB.**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

Në raport me një vit më parë, gjatë vitit 2020 shpenzimet e pushtetit vendor në raport me PBB, kanë pësuar një rënie të lehtë prej 0.07%. Nga ana tjetër, në raport me shpenzimet publike të një viti më parë, gjatë vitit 2020 shpenzimet e pushtetit vendor patën një rënie prej 1.8%. Një ndër faktorët bazë të një rënie në këtë nivel të raportit të shpenzimeve vendore me ato publike, janë jo vetëm politikat fiskale që pushteti vendor ndërmori menjëherë përmes shtyerjes së pagesës për taksat vendore e si rrjedhojë rënie të shpenzimeve publike por gjithashtu faktit që kompensimi i mungesës së të ardhurave në pushtetin qëndror u kompensua me rritjen e deficitit buxhetor, ndërkohë që pushteti vendor si pasojë e kufizimit në marrjen e borxhit uli lehtë nivelin e shpenzimeve vendore. Ky raport është një ndër treguesit më të rëndësishëm që shpreh jo vetëm rolin e pushtetit vendor por gjithashtu edhe shkallën e decentralizimit fiskal të pushtetit vendor.

**Grafiku 5: Realizimi i shpenzimeve të pushtetit vendor në vite dhe në raport me totalin të shpenzimeve publike e PBB**




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

### 3.1 Të ardhurat e pushtetit vendor

Decentralizimi fiskal si një ndër shtyllat më të rëndësishme të meanxhimit financiar publik në nivel vendor pjesën më të rëndësishme ka rritjen e të ardhurave nga burimet e veta të njësive të vetëqeverisjes vendore. Njësitë e vetëqeverisjes vendore në pëputhje më përcaktimet ligjore të ligjit për financiat vendore nga qeveria qendrore gjithashtu përfitojnë të ardhura në formën e transfertave, ku një rol të rëndësishëm e zë transferta e pakushtëzuar.

Duke marrë në analizë të ardhurat e veta vendore të klasifikuara sipas natyrës së burimit të të ardhurave, gjatë vitit 2020 për shkak të situatës ekonomike të shkaktuar nga pandemia dhe tërmeti i fundvitit 2019 njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë pësuar një trend rënës nga këto burime. Gjatë vitit 2020, pushtetit vendor ka siguruar rreth 21.9 miliard lekë të ardhura tatimore ose thënë ndryshe rreth 1.2 miliard lekë më pak të ardhura se një vit më parë. Ndërkohë, referuar të dhënave mbi të ardhurat jotatimore gjatë vitit 2020 janë mbledhur rreth 2.2 miliard lekë nga ky burim ose thënë ndryshe rreth 300 milion lekë më pak të ardhura nga ky burim në raport me vitin 2019. Si në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat në mijë lekë të realizimit të këtyre burimeve gjatë viteve 2019-2020:


**Grafiku 6: Realizimi i të ardhurave tatimore dhe jotatimore në vitin 2019 dhe 2020.**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

Të ardhurat e pushtetit vendor në vite kanë ruajtur një trend rritje të ndjeshme, duke përcaktuar në këtë mënyrë ecurinë pozitive të aftësisë së pushtetit vendor për të siguruar të ardhura. Mbajtja e këtij ritmi të rritjes së të ardhurave nga viti 2015 e në vazhdim ka konsoliduar ndjeshëm potencialin fiskal të pushtetit vendor për të ofruar shërbime cilësore në nivel vendor.


**Grafiku 7: Të ardhurat tatimore të pushtetit vendor në vite dhe ritmi i ndryshimit.**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

Transferta e pakushtëzuar si një burim i rëndësishëm i financimit të pushtetit vendor në vite ka përsuar një rritje të ndjeshme. Rritja e potencialit ekonomik jo vetëm nga të ardhurat e veta por edhe nga ato të buxhetit qendror janë një faktor shumë i rëndësishëm në nxitjen për rritjen e cilësisë së shërbimeve të pushtetit vendor. Në raport me një vit më parë, gjatë vitit 2020 transferta e pakushtëzuar ka pësuar një rënie të lehtë me rreth 400 milion lekë. Rënia e transfertës së pakushtëzuar vjen për shkak të rënies tërësore të produktit të brendshëm bruto gjatë vitit 2020, si pasojë e pandemisë, për shkak se transferta e pakushtëzuar është një tregues që llogaritet si përqindje e produktit të brendshëm bruto.


**Grafiku 8: Transferta e pakushtëzuar në vite 2011-2020.**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

Duke marrë në analizë të ardhurat sipas burimeve të pushtetit vendor konstatojmë që gjatë vitit 2020, të ardhurat e veta vendore dhe ato nga transfertat e buxhetit qendror zënë një peshë pothuajse të barabartë. Nga 51.6 miliard lekë që janë shpenzimet vendore gjatë vitit 2020, rreth 51% ose 26.1 miliard lekë e zënë shpenzimet me burim transfertat e buxhetit qendror, ndërkohë pjesa tjetër e këtyre shpenzimeve mbulohet nga të ardhurat e veta të pushtetit vendor dhe taksat e ndara. Gjatë viteve të fundit, ashtu siç mund të konstatohet në grafikun e mëposhtëm rritja e shpenzimeve vendore ka ardhur si rrjedhojë e rritjes konstante të të gjitha formave të burimit të të ardhurave vendore si në nivel qendror ashtu edhe në atë vendor.


**Grafiku 9: Të ardhurat e pushtetit vendor sipas burimit në vite**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

Një vlerë shumë të rëndësishme në këtë analizë do të ketë evidentimi i ecurisë së të ardhurave vendore sipas llojit të burimit dhe njësive të vetëqeverisjes vendore. Efekti i pandemisë COVID-19 dhe ngadalësimi ekonomik gjatë vitit 2020 reflektohet në rënien e disa nga burimeve të rëndësishme për financimin e buxhetit vendor. Në këto kushte, referuar grafikut të mëposhtëm gjatë vitit 2020 konstatohet një rënie me rreth 500 milion lekë i të ardhurave të NJVQV-ve nga “Taksa e ndikimit në infrastrukturë”, gjithashtu rënie me 150 milion lekë nga “Taksa e zënies së hapsirës publike” apo me rënie rreth 270 milion lekë të të ardhurave jotatimore në raport me vitin 2019. Nga ana tjetër, në kushtet kur shërbimet vendore pavarësisht bllokimit të situatës vazhduan të ofroheshin në eficiencë edhe të ardhurat nga këto shërbime ishin i vetmi burim që pësuan rritje gjatë vitit 2020, në raport me vitin 2019.


**Grafiku 10: Të ardhurat e veta të pushtetit vendor sipas burimit në vite**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

Nëse analizojmë rolin e burimeve të të ardhurave vendore sipas peshës që ato zënë në totalin e të ardhurave të pushtetit vendor për vitin 2020, do të eidentojmë se zëri që zë peshën më të madhe është “taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja” në rreth 37% të totalit të të ardhurave. Pas këtij zëri një peshë të rëndësishme me rreth 18% të totalit të të ardhurave të pushtetit vendor e zë “taksa mbi ndërtesën” dhe pas saj të ardhurat nga “tarifa e pastrimit dhe higjenës” me rreth 17%. Duke parë të dhënat sipas bashkive konstatohet që pjesën më të madhe të të ardhurave nga “taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja” e zë bashkia Tiranë me rreth 6.3 miliard lekë. Nëse të ardhurat nga ky burim prej 6.3 miliard lekë të bashkisë Tiranë do ti zbresim nga të ardhurat totale të pushtetit vendor atëherë zëri i taksës së ndikimit në infrastrukturë do të zërë vetëm 11% të totalit të të ardhurave të pushtetit vendor në vitin 2020.


**Grafiku 11: Përbërja e të ardhurave të pushtetit vendor sipas burimit në vitin 2020.**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

Nëse të ardhurat e veta vendore të pushtetit vendor do të grupohen nga të ardhurat në formën e taksave dhe tarifave, gjatë vitit 2020 do të konstatohet rënie në të ardhurat e këtyre burimeve në raport me vitin 2019. Të ardhurat nga tarifatat në vitin 2020 janë mbledhur vetëm 6.5 miliard lekë ose rreth 400 milion lekë më pak se të ardhurat e këtij burimi në vitin 2019. Ndërkohë të ardhurat nga taksat vendore në vitin 2020 janë akumuluar rreth 17.6 miliard lekë, ose rreth 1 miliard lekë më pak se të ardhurat e taksave vendore gjatë vitit 2019.


**Grafiku 12: Të ardhura nga taksat dhe tarifatat vendore gjatë vitit 2020**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

Një moment mjaft i rëndësishëm i analizës është vlerësimi i ndryshimit të të ardhurave të pushtetit vendor sipas njësive të vetëqeverisjes vendore. Duke marrë në analizë efektin e ndryshimit të të ardhurave sipas njësive të vetëqeverisjes vendore, do të konstatohet një shpërndarje uniforme të njësive të vetëqeverisjes vendore që kanë patur ndryshim negativ apo pozitiv nga viti 2019 në vitin 2020 të të ardhurave nga burimet e veta vendore. Rreth 30 njësi të vetëqeverisjes vendore gjatë vitit 2020 kanë patur një rënie të të ardhurave të veta vendore në raport me një vit më parë. Normën më të lartë të rënies me rreth 61% me pak të ardhura e ka bashkia Libohovë, ndërkohë që pas kësaj bashkie një normë të lartë rënie gjithashtu ka bashkia Lezhë me 57% dhe bashkia Kamëz me 37%. Gjithashtu, gjysma tjetër e njësive të vetëqeverisjes vendore gjatë vitit 2020 kanë patur një rritje në norma të ndryshme të të ardhurave, ku normën më të lartë të rritjes e ka bashkia Pukë me 93% më shumë të ardhura dhe pas saj vjen bashkia Kukës me 36% më shumë të ardhura krahasuar me vitin 2019. Gjithashtu, duke u grupuar njësitet e vetëqeverisjes vendore sipas banorëve, nuk konstatohet një lidhje ndërmjet normave të ndryshimit të të ardhurave dhe bashkive sipas madhësisë. Janë kryesisht faktorët kryesorë ekonomikë sipas vendndodhjes së njësive të vetëqeverisjes vendore që janë ndikuar në ecurinë e të ardhurave të veta të pushtetit vendor. Goditja që mori turizmi nga pandemia gjatë vitit 2020, është një tregues i rëndësishëm për rënien e të ardhurave të bashkisë Lezhë e cila ka një varësi të ndjeshme nga të ardhurat e bizneseve që ushtrojnë veprimtari turistike.

**Grafiku 13: Norma e ndryshimit të të ardhurave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore 2020/2019**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Sa i përket vlerës së mbledhur të të ardhurave të veta nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, **bashkia Tiranë** zë vendin e parë me 13,888,776 mijë lekë, shumë **e cila përbën 57.4 % të totalit të të ardhurave të mbledhura nga të gjitha bashkitë**. Bashkia Durrës renditet në vendin e dytë me 921,459 mijë lekë, e cila përbën 3.81 % të totalit të të ardhurave mbledhura nga të gjitha bashkitë. Në vendin e tretë renditet bashkia Elbasan, për të vijuar me bashkitë Vlorë Shkodër, Fier dhe Korçë, të cilat kanë arkëtuar mbi 500,000 mijë lekë të ardhura secila. Bashkitë të cilat kanë mbledhur nivelin më të ulët të të ardhurave vendore në raport me totalin e të ardhurave në rend zbritës janë: Has, Memaliaj, Këlcyrë, Libohovë dhe Pustec.

Nëse do ti referohemi totalit të të ardhurave të veta vendore për vitin 2020, bashkitë grupohen si më poshtë:

- Me të ardhura në shumën 4,000 – 50,000 mijë lekë paraqiten 19 bashki (Kolonjë, Skrapar, Mirditë, Bulqizë, Kurbin, Konispol, Pukë, Përmet, Delvinë, Tropojë, Tepelenë, Poliçan, Klos, Fushë-Arrëz, Has, Memaliaj, Këlcyrë, Libohovë, Pustec)
- Me të ardhura në shumën 50,000 – 100,000 mijë lekë paraqiten 17 bashki (Mallakastër, Devoll, Cërrik, Kuçovë, Maliq, Divjakë, Dibër, Vau i Dejës, Mat, Malësi e Madhe, Selenicë, Belsh, Finiq, Prrenjas, Gramsh, Dropull, Peqin)
- Me të ardhura në shumën 100,000 – 500,000 mijë lekë paraqiten 18 bashki (Kamëz, Sarandë, Lushnje, Himarë, Kavajë, Berat, Lezhë, Vorë, Pogradec, Krujë, Patos, Roskove, Kukës, Gjirokastrë, Shijak, Ura Vajgurore, Librazhd, Rrogozhinë).
- Me të ardhura në shumën >500,000 mijë lekë, 7 bashki (Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Shkodër, Fier, Korçë)

Nëse do ti referohemi analizës së të ardhurave sipas numrit të popullsisë:

- Të ardhurat e veta për bashkitë me popullsi nën 50,000 banorë (37 bashki) zënë më pak se 1.3 % të totalit të të ardhurave, ndër të cilat bashkitë Vorë dhe Himarë 1% deri në 1.3%, dhe 35 bashkitë e tjera më pak se 1 % të totalit të të ardhurave.
- Të ardhurat e veta për bashkitë me popullsi nga 50,000-100,000 banorë (13 bashki) zënë 0.1 – 1.6 % të totalit të të ardhurave.
- Të ardhurat e veta për bashkitë me popullsi nga 100,000 – 150,000 banorë (5 bashki) zënë 1.18 - 2 % të totalit të të ardhurave.
- Të ardhurat e veta për bashkitë me popullsi mbi 150,000 banorë (6 bashki) kanë realizuar 2.47 % - 3.8 % të totalit të të ardhurave, (Vlorë, Fier, Shkodër, Elbasan, Durrës), dhe vetëm bashkia Tiranë me 57.4 %.



Tabela1: Të ardhurat e veta sipas bashkive

Nr	Bashkia	Të ardhurat (në mijë lekë)	Pesha ne %
1	Bashkia Tirana	13,888,776	57.41%
2	Bashkia Durres	921,459	3.81%
3	Bashkia Elbasan	781,859	3.23%
4	Bashkia Vlore	653,462	2.70%
5	Bashkia Shkoder	631,519	2.61%
6	Bashkia Fier	597,345	2.47%
7	Bashkia Korce	516,200	2.13%
8	Bashkia Kamez	490,752	2.03%
9	Bashkia Sarande	400,118	1.65%
10	Bashkia Lushnje	355,687	1.47%
11	Bashkia Himare	306,683	1.27%
12	Bashkia Kavaja	302,503	1.25%
13	Bashkia Berat	290,733	1.20%
14	Bashkia Lezhe	286,248	1.18%
15	Bashkia Vore	277,158	1.15%
16	Bashkia Pogradec	273,818	1.13%
17	Bashkia Kruje	263,759	1.09%
18	Bashkia Patos	173,814	0.72%
19	Bashkia Roskovec	170,870	0.71%
20	Bashkia Kukes	156,082	0.65%
21	Bashkia Gjirokaster	150,941	0.62%
22	Bashkia Shijak	138,022	0.57%
23	Bashkia Ura Vajgurore	125,972	0.52%
24	Bashkia Librazhd	111,985	0.46%
25	Bashkia Rogozhine	101,781	0.42%
26	Bashkia Mallakaster	98,914	0.41%
27	Bashkia Devoll	98,139	0.41%
28	Bashkia Cerrik	97,445	0.40%
29	Bashkia Kucove	95,026	0.39%
30	Bashkia Maliq	88,961	0.37%
31	Bashkia Divjake	88,577	0.37%
32	Bashkia Diber	81,096	0.34%
33	Bashkia Vau-Dejes	78,627	0.33%
34	Bashkia Mat	78,116	0.32%
35	Bashkia Malesi e Madhe	67,446	0.28%
36	Bashkia Selenice	62,769	0.26%
37	Bashkia Belsh	59,738	0.25%
38	Bashkia Finiq	59,215	0.24%
39	Bashkia Prenjas	57,889	0.24%
40	Bashkia Gramsh	56,995	0.24%

Nr	Bashkia	Të ardhurat (në mijë lekë)	Pesha ne %
41	Bashkia Dropull	53,606	0.22%
42	Bashkia Peqin	53,116	0.22%
43	Bashkia Kolonje	49,577	0.20%
44	Bashkia Skrapar	43,658	0.18%
45	Bashkia Mirdite	43,261	0.18%
46	Bashkia Bulqize	42,858	0.18%
47	Bashkia Kurbin	39,264	0.16%
48	Bashkia Konispol	38,480	0.16%
49	Bashkia Puke	38,129	0.16%
50	Bashkia Permet	34,265	0.14%
51	Bashkia Delvine	34,122	0.14%
52	Bashkia Tropoje	33,223	0.14%
53	Bashkia Tepelene	31,125	0.13%
54	Bashkia Polican	30,364	0.13%
55	Bashkia Klos	28,344	0.12%
56	Bashkia Fushe-Arrez	14,363	0.06%
57	Bashkia Has	13,480	0.06%
58	Bashkia Memaliaj	12,916	0.05%
59	Bashkia Kelcyre	9,222	0.04%
60	Bashkia Libohove	7,886	0.03%
61	Bashkia Pustec	4,067	0.02%
<b>Total</b>		<b>24,191,827</b>	<b>100%</b>

Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Përsa i përket të ardhurave të mbledhura nga qarqet, qarku Lezhë zë vendin e parë me 6,970 mijë lekë, i cili përbën 52.9 % të të ardhurave të mbledhura në total nga qarqet. Në vendin e dytë renditet qarku Elbasan me 2,629 mijë lekë të ardhura, i cili përbën 20 % të të ardhurave totale të mbledhura nga qarqet. Më pas renditet qarku Shkodër, ku të ardhurat e mbledhura në renditje janë më pak se 1,000 mijë lekë, ndërkohë të ardhurat e secilit prej qarqeve, përbëjnë më pak se 10 % në raport me totalin.

Tabela 2: Të ardhurat e veta sipas qarqeve


Nr	Qarku	Të ardhurat (në mijë lekë)	Pesha ne %
1	Qarku Lezhe	6,970	52.98%
2	Qarku Elbasan	2,629	19.99%
3	Qarku Shkoder	906	6.89%
4	Qarku Vlore	491	3.74%
5	Qarku Durres	402	3.05%
6	Qarku Gjirokaster	347	2.64%
7	Qarku Korce	338	2.57%
8	Qarku Kukes	275	2.09%
9	Qarku Tirane	273	2.08%
10	Qarku Diber	224	1.70%
11	Qarku Berat	195	1.48%
12	Qarku Fier	105	0.80%
<b>Total</b>		<b>13,155</b>	<b>100%</b>

Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

### 3.2 Shpenzimet e pushtetit vendor

Efektet e pandemisë COVID-19 dhe tërmeti i nëntorit 2019 kanë shkaktuar një luhatje të ndjeshme në shpenzimet e pushtetit vendor, kryesisht në gjysmën e parë të vitit 2020. Shumë procese të menaxhimit financiar publik në nivel vendor u ndikuan si pasoje e bllokimit të proceseve normale të zhvillimit ekonomik në tërësi. Në këtë drejtim nuk bën përjashtim efekti i shkaktuar nga situata ekonomike në shpenzimet e pushtetit vendor. Gjatë vitit 2020, pushteti vendor ka një rënie të shpenzimeve të cilat financohen nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar sektoriale apo e përgjithshme, apo të ardhurat nga burimet e veta, me rreth 8% në raport me një vit më parë. Kjo rënie në vlerë absolute është evidentuar në vlerën e rreth 5 miliard lekë më pak shpenzime krahasuar me vitin 2019.

Grafiku 14: Realizimi i shpenzimeve të pushtetit vendor në vite dhe ritmi i ndryshimit në vite.




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

Ashtu sic mund të konstatohet në grafikun e mësipërm, shpenzimet e pushtetit vendor kanë ndjekur një trend rritje duke konkretizuar në vite konsolidimin e menaxhimit financiar të pushtetit vendor. Ky trend identifikohet qartë jo vetëm në vlerë absolute por gjithashtu edhe në raport me produktin e brendshëm bruto apo shpenzimet publike.

Përfundimisht në vitin 2020 ky trend i treguesve të shpenzimeve të pushtetit vendor është në rënie. Në raport me një vit më parë, gjatë vitit 2020 shpenzimet e pushtetit vendor në raport me PBB, kanë pësuar një rritje të lehtë prej 0.1%. Nga ana tjetër, në raport me shpenzimet publike të një viti më parë, gjatë vitit 2020 shpenzimet e pushtetit vendor patën një rënie prej 1.8%. Një ndër faktorët bazë të një rënie në këtë nivel të raportit të shpenzimeve vendore me ato publike, janë jo vetëm politikat fiskale që pushteti vendor ndërmori menjëherë përmes shtyrjes së pagesës për taksat vendore e si rrjedhojë rënie të shpenzimeve publike por gjithashtu faktit që kompensimi i mungesës së të ardhurave në pushtetin qëndror u kompensua me rritjen e deficitit buxhetor, ndërkohë që pushteti vendor si pasojë e kufizimit në marrjen e borxhit uli lehtë nivelin e shpenzimeve vendore. Ky raport është një ndër treguesit më të rëndësishëm që shpreh jo vetëm rolin e pushtetit vendor por gjithashtu edhe shkallën e decentralizimit fiskal të pushtetit vendor.

Duke marrë në analizë shpenzimet sipas llogarive ekonomike konstatohet që peshën më të madhe të këtyre shpenzimeve gjatë vitit 2020 e zënë shpenzimet për paga dhe sigurime që zënë rreth 43% të totalit të shpenzimeve vendore. Në raport me një vit më parë konstatohet që shpenzimet për investime kanë një rënie me rreth 5 miliard lekë, ndërkohë që shpenzimet e personelit dhe ato operative kanë një rritje të lehtë përkatësisht me 550 milion lekë dhe 200 milion lekë krahasuar me shpenzimet e vitit 2019. Pushteti vendor, gjatë vitit 2020 si pasojë e situatës pandemike të krijuar për financimin e shumë shërbimeve jetike për qytetarët në shumë raste u shoqërua me rialokime buxhetore në funksion të realizimit të shërbimeve bazë duke ulur nivelin fillestar të investimeve të planifikuara.


**Grafiku 15: Shpenzimet sipas llogarive ekonomike të pushtetit vendor për vitin 2020-2019.**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

Problematikën më të madhe në vitin 2020 e kanë pësuar shpenzimet për investime, me një rënie në rreth 28% më pak se viti 2019. Përpjekjet e vazhdueshme të pushtetit vendor që fondet ti vendosin në funksion të zbutjes së problematikave sociale dhe gjithashtu mbulimit të shërbimeve jetike me ndikim të drejtpërdrejtë tek qytetarët, bëri që pothuajse të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore të rialokonin shpenzimet duke zbritur investimet e planifikuara dhe financuar këto shpenzime.


**Grafiku 16: Pesa e shpenzimeve sipas llogarive ekonomike të pushtetit vendor për vitin 2020-2019.**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

Një aspekt mjaft i rëndësishëm i analizës së treguesve të realizimit të shpenzimeve të pushtetit vendor për vitin 2020 është edhe pesha që zënë shpenzimet sipas funksioneve të pushtetit vendor. Gjatë vitit 2020, pushteti vendor ka financuar në pjesën më të madhe të shpenzimeve funksionet e “Shërbimeve të përgjithshme publike” dhe “Arsimit”, përkatësisht në masën 22% dhe 20% të totalit të shpenzimeve vendore. Nëse analizën sipas funksioneve do ta realizojmë krahasuar me një vit më parë, do të konstatojmë ndryshime të vogla në rritje në dy funksionet e sipërcituara, ndërkohë rënie kanë pësuar funksione të tilla si “Mbrojtja e Mjedisit” apo dhe “Argëtimi, kultura dhe feja”. Këto ndryshime në raport me një vit më parë, tregojnë qartë lëvizjen e fondeve buxhetore gjatë vitit 2020 në funksion të mbulimit të shërbimeve të rëndësishme publike si pasojë e situatës pandemike.


**Grafiku 17: Peshat e shpenzimeve të pushtetit vendor sipas klasifikimit funksional për vitet 2020-2019.**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

Pushteti vendor siguron të ardhura jo vetëm nga burimet e veta por gjithashtu edhe nga transfertat e buxhetit qendror në përputhje me përcaktimet ligjore. Roli i transfertës së pakushtëzuar në financimin e veprimtarisë së pushtetit vendor është konstant ndër vite. Ashtu siç mund të shihet në grafikun e mëposhtëm, shpenzimet e pushtetit vendor sipas burimit gjatë vitit 2020 janë mbuluar pothuajse në mënyrë të barabartë ndërmjet transfertës së pakushtëzuar dhe të ardhurave të veta vendore. Ky trend i burimit të financimit gjatë vitit 2020 nuk ka ndryshuar krahasuar me një vit më parë, i vetmi ndryshim i vogël është rënia e burimit “Financimi i huaj” në mbulimin e shpenzimeve vendore.


**Grafiku 18: Peshat e shpenzimeve të pushtetit vendor sipas burimit të financimit për vitin 2020-2019.**



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

Gjatë vitit 2020, shpenzimet e pushtetit vendor kanë pësuar ndryshime në disa prej funksioneve bazë si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia dhe domosdoshmërisë për të ofruar disa shërbime bazë për qytetarët. Si rrjedhojë e rënies në tërësi të shpenzimeve vendore nga tkurrja e ekonomisë, një levizje të vogël në raport me vitin 2019 gjatë vitit 2020 e kanë pësuar funksioni “Shërbime të Përgjithshme Publike” me 0.5% më pak, “Strehimi dhe komoditetet e komunitetit” me 19% më pak apo funksioni i “Mbrojtjes Sociale” me 32.7% më pak. Nga ana tjetër, rritje të shpenzimeve kanë ndodhur në funksionet e “Mbrojtjes së mjedisit” me 109% apo “Çështjet ekonomike” me 28% si rrjedhim i politikave vendore që lidhen me pastrimin e gjelbërimin gjatë pandemisë dhe asistencës së drejtpërdrejtë për ringritjen ekonomike. Gjithashtu, ajo çfarë është më e rëndësishmja në politikat vendore të vitit 2020, është vëmendja dhe fokusi i dhënë funksionit të “Shëndetësisë” i cili shoqërohet me rritje të shpenzimeve për këtë funksion me rreth 12.5% më shumë se në vitin 2019.

**Grafiku 19: Ndryshimi i shpenzimeve në nivel funksioni 2020/2019.**




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

Nëse do të marrim në analizë një aspekt të rëndësishëm të politikave vendore në menaxhimin e financave për financimin e funksioneve ligjore sipas burimeve të të ardhurave do të konstatojmë një shpërndarje si në grafikun e mëposhtëm. Nga të dhënat evidentohet që vetëm funksioni “Shërbime të Përgjithshme Publike” financohet në mënyrë të barabartë mes

transfertave të pushtetit qendror dhe të ardhurave të veta të pushtetit vendor. Ndërkohë nga të ardhurat e veta pushteti vendor financon më shumë funksionet e “Çështjeve ekonomike”, “Mbrojtja e mjedisit” apo funksioni “Argëtimi, kultura dhe feja”. Funksionet të cilat janë financuar kryesisht me transfertat që pushteti vendor merr nga ai qendror janë të tilla si “Rendi dhe siguria publike”, “Arsimi” dhe “Mbrojtja Sociale”. Njësitë e vetëqeverisjes vendore përmes transfertave të buxhetit qendror, kanë mbuluar disa prej funksioneve që i përkasin shërbimeve bazë ndaj komunitetit, si një metodologji kjo për të siguruar plotësisht shërbimet bazë ndaj qytetarëve.

**Grafiku 20: Shpenzimet e pushtetit vendor sipas funksioneve dhe burimit të financimit gjatë vitit 2020**




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

Duke marrë në analizë ndryshimin në shpenzimet e pushtetit vendor nga viti 2019 në vitin 2020 sipas njësive të vetëqeverisjes vendore konstatohen të dhënat si në grafikun e mëposhtëm. Rreth 39 bashki nga totali kanë patur një rënie të shpenzimeve në vitin 2020 në raport me shpenzimet e realizuara në vitin 2019. Bashkitë që kanë patur rënie më të madhe janë bashkitë Vorë me një rënie prej 44%, bashkia Vau Dejës me rreth 38% apo bashkia Kamëz me rreth 23% rënie të shpenzimeve. Nga ana tjetër, pjesa e mbetur prej 22 bashkive kanë patur rritje të shpenzimeve në vitin 2020 në raport me vitin 2019. Bashkitë të cilat kanë patur rritjen më të madhe të shpenzimeve gjatë vitit 2020 janë bashkitë të tilla si bashkia Rogozhinë me një rritje prej 48% apo bashkia Prrenjas me një rritje prej 27% në raport me vitin 2019. Ndryshimi i shpenzimeve në rënie në shumicën e njësive të vetëqeverisjes vendore, ku përfshihen kryesisht bashkitë që zënë një peshë të madhe në totalin e shpenzimeve të pushtetit vendor janë një tregues i rëndësishëm i ndikimit që ka patur efekti i pandemisë në rënie ekonomike në tërësi dhe që reflektohet tek njësitë e vetëqeverisjes vendore.



Grafiku 21: Norma e ndryshimit të shpenzimeve të njëjive të vetëqeverisjes vendore 2020/2019



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

### 3.3 Detyrimet e prapambetura

Stoku i detyrimeve të prapambetura për njësitë e vetëqeverisjes vendore në fund të muajit dhjetor 2020, i cili parashikohet të shlyhet në një periudhë afatmesme, bazuar në planin e shlyerjes së dërguar nga të gjitha bashkitë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë është rreth **6.9 miliard lekë**. Vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura është ulur me **1.2 miliard lekë** krahasuar me stokun e detyrimit në fund të vitit 2019, që ishte **8.1 miliard lekë**.

Stokun më të lartë të detyrimeve e ka **bashkia Tiranë** në vlerën rreth **762 milion lekë**, e cila përbën 11% të totalit të detyrimeve, **bashkia Kavajë** në vlerën rreth **728 milion lekë**, e cila përbën 10.5% të totalit të detyrimeve, **bashkia Vorë** në vlerën rreth **703 milion lekë**, e cila përbën 10.1% të totalit të detyrimeve, **bashkia Pogradec** në vlerën rreth **339 milion lekë**, e cila përbën 4.9% të totalit të detyrimeve.

Ndërsa, sa i përket Këshillave të Qarqeve, stokun më të lartë të detyrimit e ka **Këshilli i qarkut Durrës** në vlerën **63 milion lekë**, e cila përbën 49.2% të totalit të detyrimeve, **qarku Berat** në vlerën **42 milion lekë**, e cila përbën 32.9% të totalit të detyrimeve, **qarku Gjirokastrë** në vlerën rreth **19 milion lekë**, e cila përbën 14.6% të totalit të detyrimeve.

Sipas kategorive, peshën më të madhe të stokut të detyrimeve e zë kategoria “Investime” me 54.4%, kategoria “Të tjera” 17.3%, “Shërbime” 10.3%, dhe “Vendime Gjyqësore” 10%. Ndërsa sa i përket qarqeve, stoku i detyrimit të tyre përbëhet kryesisht nga vendime gjyqësore, të cilat zënë 95.3% të totalit të detyrimit të qarqeve.

Tabela 3: Detyrimet e prapambetura sipas kategorive

*në lekë*

Llog. Ekonomike	Kategoria	Bashki	Qarqe	Pesha në % Bashki	Pesha në % Qarqe
4864100	Vendime Gjyqësore	692,025,933	122,257,766	10.0%	95.3%
4864200	Det.Prap. Shërbime	716,505,694	2,068,017	10.3%	1.6%
4864300	Det.Prap. Mirembajtje	247,250,606	0	3.6%	0.0%
4864400	Det.Prap. Investime	3,769,240,374	739,225	54.4%	0.6%
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH	1,774,446	0	0.0%	0.0%
4864600	Mallra	245,428,057	1,284,342	3.5%	1.0%
4864900	Det.Prap.Te Tjera	1,195,677,167	1,954,484	17.3%	1.5%
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore	31,050,100	0	0.4%	0.0%
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet	2,843,748	0	0.0%	0.0%
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal	20,451,877	0	0.3%	0.0%
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera	8,391,753	0	0.1%	0.0%
	<b>TOTAL</b>	<b>6,930,639,755</b>	<b>128,303,834</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>

Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

## 4. Procesi i rindërtimit në treguesit fiskalë të pushtetit vendor

Procesi i Rindërtimit është një proces i integruar zhvillimi i përbërë nga pesë programe, në funksion të rindërtimit pas tërmetit, përmirësimit të kushteve të jetesës dhe të shëndetit pas shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore (Sikurse është parashikuar në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” dhe VKM në zbatim të tij). Fondi i Rindërtimit është përdorur nga njësitë vendore për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019. Mënyra e përdorimit të Fondit të Rindërtimit, programet buxhetore ku janë alokuar fondet si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore përfituese, janë përcaktuar gjatë vitit 2020 nga Këshilli i Ministrave. Programet të cilat janë financuar nga fondi i rindërtimit për vitin 2020 janë si më poshtë:

1. Programi i zhvillimit të objekteve të reja
2. Programi i ndërtimit të infrastrukturës publike
3. Programi i krijimit të fondit të banesave
4. Programi i granteve të rindërtimit
5. Programi i masave të rimëkëmbjes sociale dhe ekonomike

Nga fondi i planifikuar prej **29 miliardë lekësh** nga shpenzimet e buxhetit, për vitin 2020 janë akorduar **14,9 miliardë lekë** në formën e trasfertës së pakushtëzuar për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, të cilat janë realizuar në masën **56 për qind**, ose **8.3 miliardë lekë**. Në fund të vitit buxhetor 2020, fondet e pashpenzuara janë trashëguar për tu përdorur në vitin pasardhës dhe do të përdoren për të njëjtin qëllim. Në tabelën e mëposhtme paraqitet shpërndarja e fondit sipas bashkive përfituese.

Tabela 4: Fondet e rindërtimit sipas bashkive përfituese

në 000/lekë

Nr.	Njësia Vendore	Plan 2020	Fakt 2020	Realizimi (në %)
1	Bashkia Tiranë	5,919,650	2,154,087	36%
2	Bashkia Durrës	4,949,880	3,708,237	75%
3	Bashkia Kamëz	18,264	18,264	100%
4	Bashkia Kavaje	18,250	0	0%
5	Bashkia Krujë	1,056,325	754,835	71%
6	Bashkia Kurbin	1,249,242	574,906	46%
7	Bashkia Lezhë	541,630	376,376	69%
8	Bashkia Shijak	1,155,506	798,504	69%
<b>Total</b>		<b>14,908,747</b>	<b>8,385,209</b>	<b>56%</b>

Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

Financimi i procesit të rindërtimit në njësitë e vetëqeverisjes vendore kryesisht është përqendruar në: *rindërtimin e banesave individuale, rindërtimin e objekteve arsimore, rikonstruksionin dhe riparimin e banesave individuale, të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), hartim të projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve që janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore.*


## 5. Analiza e buxheteve sipas njësive të vetëqeverisjes vendore

Efekti i pandemisë Covid-19, është ndjerë pothuajse në të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore të cilat paraqiten me rënie në 12-mujorin e vitit 2020, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019. Si më poshtë vijon janë analizuar të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore sipas zërave kryesorë të të ardhurave të veta (2020/2019), si dhe shpenzimet për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore.

### 5.1 Analiza e buxheteve sipas bashkive në të ardhura dhe shpenzime

#### 152 Bashkia Belsh

Gjatë vitit 2020, bashkia Belsh, ka realizuar **59,738 mijë lekë** të ardhura të veta, ndër të cilat 57,391 mijë lekë, ose 96 % janë të ardhura tatimore. Të ardhurat e bashkisë Belsh krahasuar me vitin 2019, janë rritur me 23 %. Siç vihet re edhe nga grafiku i mëposhtëm ndër taksat dhe tarifat të cilat paraqiten me ulje në vitin 2020, krahasuar me vitin 2019 janë: taksa mbi tokën bujqësore (-15%), taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (-56%), tarifa vendore për zënien e hapësirave publike (-61%). Ndërkohë, taksa mbi ndërtesën është rritur në masën 75% krahasuar me vitin 2019, dhe tarifa e pastrimit dhe higjienës është rritur në masën 64 %. Taksat kryesore të cilat zënë peshën më të madhe në totalin e të ardhurave të veta janë: taksa mbi ndërtesën e cila përbën 54 % të totalit; taksa mbi tokën bujqësore, e cila përbën 33 % të totalit.




Në vitin 2020, bashkia Belsh me një popullsi prej 33,632 banorë ka realizuar në total **284,988 mijë lekë** shpenzime. Në krahasim me vitin 2019, këto shpenzime janë rritur me rreth 54,580 mijë lekë, ku në vitin 2019 ato ishin rreth 230,408 mijë lekë. Në tabelën e mëposhtme, paraqiten shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në fakt:

në mijë lekë

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferencat vjetore 2020-2019	Raporti i ndryshimit
	2020	2019	2018	2017		
<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>208,524</b>	<b>164,097</b>	<b>167,952</b>	<b>159,902</b>	<b>44,427</b>	<b>127%</b>
<i>Personeli</i>	145,399	115,129	123,102	112,783	30,270	126%
<i>Operative</i>	60,260	44,181	42,941	44,271	16,079	136%
<i>Të tjera</i>	2,865	4,787	1,909	2,848	-1,922	60%
<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>76,464</b>	<b>66,311</b>	<b>24,434</b>	<b>123,169</b>	<b>10,153</b>	<b>115%</b>
<b>TOTALI</b>	<b>284,988</b>	<b>230,408</b>	<b>192,386</b>	<b>283,071</b>	<b>54,580</b>	<b>124%</b>


Për vitin 2020, bashkia Belsh ka kryer 8.7 mijë lekë shpenzime për banor, nga të cilat 4.3 mijë lekë shpenzime personeli për banor dhe 2.2 mijë lekë shpenzime për investime për banor.

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2020 është rreth 51%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 21% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 1%, ndërsa ato për investime rreth 27%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2019 jepet si më poshtë:



## 102 Bashkia Berat

Gjatë vitit 2020, bashkia Berat, ka realizuar **290,733 mijë lekë** të ardhura të veta, ndër të cilat 268,512 mijë lekë, ose 92.3 % janë të ardhura tatimore. Të ardhurat e bashkisë Berat krahasuar me vitin 2019, janë rritur me 4 %. Siç vihet re edhe nga grafiku i mëposhtëm ndër taksat dhe tarifatat të cilat paraqiten me ulje në vitin 2020, krahasuar me vitin 2019 janë: taksa mbi ndërtesën (-8%), taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (-290 %), tarifa vendore për zënien e hapësirave publike (-52 %). Ndërkohë, taksa mbi tokën bujqësore është rritur në masën 22% krahasuar me vitin 2019, dhe tarifa e pastrimit dhe higjienës është rritur në masën 14 %. Taksat kryesore të cilat zënë peshën më të madhe në totalin e të ardhurave të veta janë: taksa mbi ndërtesën e cila përbën 40 % të totalit; taksa vendore e gjelbërt, e cila përbën 24 % të totalit.




Në vitin 2020, bashkia Berat me një popullsi prej 100,035 banorë ka realizuar në total **839,284 mijë lekë** shpenzime. Në krahasim me vitin 2019, këto shpenzime janë ulur me rreth 64,527 mijë lekë, ku në vitin 2019 ato ishin rreth 903,812 mijë lekë. Në tabelën e mëposhtme, jepen shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në fakt:

në mijë lekë

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferencat vjetore 2020-2019	Raporti i ndryshimit
	2020	2019	2018	2017		
<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>728,015</b>	<b>658,495</b>	<b>705,378</b>	<b>669,454</b>	<b>69,521</b>	<b>111%</b>
Personeli	465,890	479,791	467,723	434,643	-13,901	97%
Operative	228,024	150,670	208,451	180,499	77,354	151%
Të tjera	34,101	28,033	29,204	54,312	6,068	122%
<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>111,269</b>	<b>245,317</b>	<b>163,739</b>	<b>201,868</b>	<b>-134,048</b>	<b>45%</b>
<b>TOTALI</b>	<b>839,284</b>	<b>903,812</b>	<b>869,117</b>	<b>871,322</b>	<b>-64,527</b>	<b>93%</b>


Për vitin 2020, bashkia Berat ka kryer 8.3 mijë lekë shpenzime për banor, nga të cilat 4.6 mijë lekë shpenzime personeli për banor dhe 1.1 mijë lekë shpenzime për investime për banor.

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2020 është rreth 56%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 27% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 4%, ndërsa ato për investime rreth 13%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:



## 103 Bashkia Bulqizë

Gjatë vitit 2020, bashkia Bulqizë, ka realizuar **42,858 mijë lekë** të ardhura të veta, ndër të cilat 37,286 mijë lekë, ose 87 % janë të ardhura tatimore. Të ardhurat e bashkisë Bulqizë krahasuar me vitin 2019, janë ulur me 15.2 %. Siç vihet re edhe nga grafiku i mëposhtëm taksa e cila paraqitet me ulje në vitin 2020, krahasuar me vitin 2019 është taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (-14%), ndërkohë, taksa mbi ndërtesën është rritur në masën 17%, taksa mbi tokën bujqësore është rritur në masën 38%, tarifa e pastrimit dhe higjienës është rritur në masën 9 %. Taksat kryesore të cilat zënë peshën më të madhe në totalin e të ardhurave të veta janë: taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja e cila përbën 59 % të totalit; taksa mbi ndërtesën, e cila përbën 27 % të totalit.



Në vitin 2020, bashkia Bulqizë me një popullsi prej 40,223 banorë ka realizuar në total **465,295 mijë lekë** shpenzime. Në krahasim me vitin 2019, këto shpenzime janë ulur me rreth 110,645 mijë lekë, ku në vitin 2019 ato ishin rreth 575,940 mijë lekë. Në tabelën e mëposhtme, jepen shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në fakt:


në mijë lekë

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferencat vjetore 2020-2019	Raporti i ndryshimit
	2020	2019	2018	2017		
<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>362,833</b>	<b>354,351</b>	<b>330,480</b>	<b>287,553</b>	<b>8,482</b>	<b>102%</b>
Personeli	230,289	221,298	213,088	195,774	8,991	104%
Operative	118,643	130,762	107,393	90,308	-12,119	91%
Të tjera	13,901	2,291	10,000	1,471	11,610	607%
<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>102,463</b>	<b>221,589</b>	<b>95,486</b>	<b>101,168</b>	<b>-119,127</b>	<b>46%</b>
<b>TOTALI</b>	<b>465,295</b>	<b>575,940</b>	<b>425,967</b>	<b>388,721</b>	<b>-110,645</b>	<b>81%</b>




Për vitin 2020, bashkia Bulqizë ka kryer 11.5 mijë lekë shpenzime për banor, nga të cilat 5.7 mijë lekë shpenzime personeli për banor dhe 2.5 mijë lekë shpenzime për investime për banor.

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2020 është rreth 49%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 25% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 3%, ndërsa ato për investime rreth 22%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2019 jepet si më poshtë:



## 110 Bashkia Cërrik

Gjatë vitit 2020, bashkia Cërrik, ka realizuar **97,445 mijë** lekë të ardhura të veta, ndër të cilat 88,697 mijë lekë, ose 91 % janë të ardhura tatimore. Të ardhurat e bashkisë Cërrik krahasuar me vitin 2019, janë rritur me 8.8 %. Siç vihet re edhe nga grafiku i mëposhtëm ndër taksat dhe tarifat të cilat paraqiten me ulje në vitin 2020, krahasuar me vitin 2019 janë: taksa mbi tokën bujqësore (-12%) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (-105 %), të ardhurat jo-tatimore (-12%). Ndërkohë, tarifa e pastrimit dhe higjienës është rritur në masën 13 %. Taksat kryesore të cilat zënë peshën më të madhe në totalin e të ardhurave të veta janë: taksa mbi truallin, e cila përbën 37 % të totalit; taksa mbi ndërtesën, e cila përbën 31 % të totalit.




Në vitin 2020, bashkia Cërrik me një popullsi prej 47,859 banorë ka realizuar në total **322,611 mijë lekë** shpenzime. Në krahasim me vitin 2019, këto shpenzime janë ulur me rreth 26,909 mijë lekë, ku në vitin 2019 ato ishin rreth 349,519 mijë lekë. Në tabelën e mëposhtme, jepen shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në fakt:

në mijë lekë


Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferencat vjetore 2020-2019	Raporti i ndryshimit
	2020	2019	2018	2017		
<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>256,323</b>	<b>260,670</b>	<b>236,905</b>	<b>227,656</b>	<b>-4,346</b>	<b>98%</b>
Personeli	166,873	184,582	164,627	151,074	-17,709	90%
Operative	77,849	68,163	68,052	72,661	9,686	114%
Të tjera	11,601	7,925	4,226	3,921	3,677	146%
<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>66,287</b>	<b>88,850</b>	<b>44,675</b>	<b>91,445</b>	<b>-22,562</b>	<b>75%</b>
<b>TOTALI</b>	<b>322,611</b>	<b>349,519</b>	<b>281,580</b>	<b>319,101</b>	<b>-26,909</b>	<b>92%</b>

Për vitin 2020, bashkia Cërrik ka kryer 6.7 mijë lekë shpenzime për banor, nga të cilat 3.4 mijë lekë shpenzime personeli për banor dhe 1.3 mijë lekë shpenzime për investime për banor. Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2020 është rreth 52%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 24% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 4%, ndërsa ato për investime rreth 21%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2019 jepet si më poshtë:



## 104 Bashkia Delvinë

Gjatë vitit 2020, Delvinë, ka realizuar **34,122 mijë** lekë të ardhura të veta, ndër të cilat 21,325 mijë lekë, ose 62.5 % janë të ardhura tatimore. Të ardhurat e bashkisë Delvinë krahasuar me vitin 2019, janë rritur me 17.9 %. Siç vihet re edhe nga grafiku i mëposhtëm ndër taksat dhe tarifat të cilat paraqiten me ulje në vitin 2020, krahasuar me vitin 2019 janë: taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (-43%), tarifa vendore për zënien e hapësirës publike (-66%). Ndërkohë, taksa mbi ndërtesën është rritur në masën 18% dhe të ardhurat jo-tatimore janë rritur në masën 30%. Taksat kryesore të cilat zënë peshën më të madhe në totalin e të ardhurave të veta janë: taksa mbi tokën bujqësore e cila përbën 47 % të totalit; taksa mbi ndërtesën, e cila përbën 31 % të totalit.




Në vitin 2020, bashkia Delvinë me një popullsi prej 17,954 banorë ka realizuar në total **162,498 mijë lekë** shpenzime. Në krahasim me vitin 2019, këto shpenzime janë ulur me rreth 1,059 mijë lekë, ku në vitin 2019 ato ishin rreth 163,557 mijë lekë. Në tabelën e mëposhtme, jepen shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në fakt:

në mijë lekë

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferencat vjetore 2020-2019	Raporti i ndryshimit
	2020	2019	2018	2017		
<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>140,535</b>	<b>130,662</b>	<b>135,956</b>	<b>125,006</b>	<b>9,873</b>	<b>108%</b>
Personeli	101,941	103,007	101,172	94,130	-1,066	99%
Operative	38,246	27,434	34,298	27,684	10,811	139%
Të tjera	348	221	486	3,192	127	158%
<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>21,963</b>	<b>32,894</b>	<b>43,812</b>	<b>48,142</b>	<b>-10,931</b>	<b>67%</b>
<b>TOTALI</b>	<b>162,498</b>	<b>163,557</b>	<b>179,768</b>	<b>173,148</b>	<b>-1,059</b>	<b>99%</b>


Për vitin 2020, bashkia Delvinë ka kryer 9 mijë lekë shpenzime për banor, nga të cilat 5.6 mijë lekë shpenzime personeli për banor dhe 1.2 mijë lekë shpenzime për investime për banor.

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2020 është rreth 63%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 24% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 0.2%, ndërsa ato për investime rreth 14%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2019 jepet si më poshtë:



## 105 Bashkia Devoll

Gjatë vitit 2020, Devoll, ka realizuar **98,1139 mijë** lekë të ardhura të veta, ndër të cilat 82,245 mijë lekë, ose 83.8 % janë të ardhura tatimore. Të ardhurat e bashkisë Devoll krahasuar me vitin 2019, janë ulur me 7.6 %. Siç vihet re edhe nga grafiku i mëposhtëm ndër taksat dhe tarifatat të cilat paraqiten me ulje në vitin 2020, krahasuar me vitin 2019 janë: taksa mbi ndërtesën (-386%), taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (-12%), ndërkohë taksa vendore e zënies së hapësirave publike është rritur në masën 42%, tarifa e pastrimit dhe higjienës është rritur në masën 22%. Taksat kryesore të cilat zënë peshën më të madhe në totalin e të ardhurave të veta janë: Taksa mbi tokën bujqësore e cila përbën 60 % të totalit; taksa mbi truallin e cila përbën 13 % të totalit.




Gjatë vitit 2020, bashkia Vlorë ka realizuar **653,462 mijë** lekë të ardhura të veta, ndër të cilat 563,741 mijë lekë, ose 86.2 % janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2019, të ardhurat e bashkisë Vlorë janë rritur me 4.8 %. Siç vihet re edhe nga grafiku i mëposhtëm ndër taksat dhe tarifat të cilat paraqiten me ulje në vitin 2020, krahasuar me vitin 2019 janë: taksa mbi ndërtesën (-54%), tarifa vendore për zënien e hapësirave publike (-47%), tarifa e pastrimit dhe higjienës (-24%), taksa të tjera vendore (-9%), ndërkohë taksa mbi tokën bujqësore është rritur në masën 15%, taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është rritur në masën 66%, ndërsa të ardhurat jo-tatimore janë rritur në masën 3%. Taksat kryesore të cilat zënë peshën më të madhe në totalin e të ardhurave të veta janë: Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja e cila përbën 51 % të totalit; taksa mbi ndërtesën e cila përbën 30 % të totalit.




Në vitin 2020, bashkia Vlorë me një popullsi prej 202,791 banorë ka realizuar në total 1,657,740 mijë lekë shpenzime. Në krahasim me vitin 2019, këto shpenzime janë ulur me rreth 27,908 mijë lekë, ku në vitin 2019 ato ishin rreth 1,685,648 mijë lekë. Në tabelën e mëposhtme, jepen shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në fakt:

në mijë lekë


Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferencat vjetore 2020-2019	Raporti i ndryshimit
	2020	2019	2018	2017		
<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>1,488,874</b>	<b>1,497,117</b>	<b>1,425,773</b>	<b>1,180,799</b>	<b>-8,243</b>	<b>99%</b>
<i>Personeli</i>	733,816	664,425	614,543	572,810	69,391	110%
<i>Operative</i>	688,917	770,128	779,149	563,271	-81,210	89%
<i>Të tjera</i>	66,141	62,565	32,080	44,718	3,577	106%
<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>168,866</b>	<b>188,531</b>	<b>95,723</b>	<b>542,629</b>	<b>-19,665</b>	<b>90%</b>
<b>TOTALI</b>	<b>1,657,740</b>	<b>1,685,648</b>	<b>1,521,497</b>	<b>1,723,428</b>	<b>-27,908</b>	<b>98%</b>

Për vitin 2020, bashkia Vlorë ka kryer 8.1 mijë lekë shpenzime për banor, nga të cilat 3.6 mijë lekë shpenzime personeli për banor dhe 0.8 mijë lekë shpenzime për investime për banor. Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2020 është rreth 44%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 42% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 4%, ndërsa ato për investime rreth 10%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2019 jepet si më poshtë:



## 165 Bashkia Vorë

Gjatë vitit 2020, bashkia Vorë ka realizuar **277,158 mijë** lekë të ardhura të veta, ndër të cilat 270,991 mijë lekë, ose 97.8 % janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2019, të ardhurat e bashkisë Vorë janë ulur me 28.7 %. Siç vihet re edhe nga grafiku i mëposhtëm ndër taksat dhe tarifatat të cilat paraqiten me ulje në vitin 2020, krahasuar me vitin 2019 janë: taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (-215%) dhe të ardhurat jo-tatimore (-32%), ndërkohë taksa mbi ndërtesën është rritur në masën 1%, taksa mbi tokën bujqësore në masën 24%, tarifa e pastrimit dhe higjienës në masën 9%, taksa të tjera vendore në masën 11%. Taksat kryesore të cilat zënë peshën më të madhe në totalin e të ardhurave të veta janë: taksa mbi ndërtesën e cila përbën 53 % të totalit ; taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja e cila përbën 28 % të totalit.




Në vitin 2020, bashkia Vorë me një popullsi prej 39,592 banorë ka realizuar në total 343,703 mijë lekë shpenzime. Në krahasim me vitin 2019, këto shpenzime janë ulur me rreth 272,248 mijë lekë, ku në vitin 2019 ato ishin rreth 615,951 mijë lekë. Në tabelën e mëposhtme, jepen shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në fakt:

në mijë lekë

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferencat vjetore 2020-2019	Raporti i ndryshimit
	2020	2019	2018	2017		
<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>280,930</b>	<b>348,263</b>	<b>391,652</b>	<b>259,576</b>	<b>-67,334</b>	<b>81%</b>
<i>Personeli</i>	209,039	207,046	202,535	182,229	1,993	101%
<i>Operative</i>	57,391	98,333	145,604	51,306	-40,942	58%
<i>Të tjera</i>	14,500	42,884	43,513	26,041	-28,384	34%
<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>62,774</b>	<b>267,688</b>	<b>285,890</b>	<b>198,020</b>	<b>-204,914</b>	<b>23%</b>
<b>TOTALI</b>	<b>343,703</b>	<b>615,951</b>	<b>677,541</b>	<b>457,596</b>	<b>-272,248</b>	<b>56%</b>

Për vitin 2020, bashkia Vorë ka kryer 8.6 mijë lekë shpenzime për banor, nga të cilat 5.2 mijë lekë shpenzime personeli për banor dhe 1.5 mijë lekë shpenzime për investime për banor.

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2020 është rreth 61%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 17% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 4%, ndërsa ato për investime rreth 18%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2019 jepet si më poshtë:



## 5.2 Analiza e buxheteve sipas Këshillave të Qarqeve në të ardhura dhe shpenzime

### 042 Këshilli i Qarkut Berat


Gjatë vitit 2020, Qarku Berat ka realizuar **195 mijë lekë të ardhura**, të cilat zënë 1.5 % të të ardhurave të mbledhura nga qarqet, duke e renditur qarkun Berat në vendin e 11-të, të renditjes së qarqeve sipas realizimit të të ardhurave. Në realizimin e të ardhurave, totali i të ardhurave të mbledhura janë të ardhura jotatimore. Krahasuar me vitin 2019, të ardhurat e vitit 2020 të Qarkut Berat janë ulur me 55.1 %.

Në vitin 2020, Këshilli i Qarkut Berat ka realizuar në total 31,531 mijë lekë shpenzime. Në krahasim me vitin 2019, këto shpenzime janë rritur me rreth 2,547 mijë lekë, ku në vitin 2019 ato ishin rreth 28,984 mijë lekë. Në tabelën e mëposhtme, jepen shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në fakt:

në mijë lekë

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferencat vjetore 2020-2019	Raporti i ndryshimit
	2020	2019	2018	2017		
<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>23,124</b>	<b>28,485</b>	<b>29,279</b>	<b>29,780</b>	<b>-5,361</b>	<b>81%</b>
<i>Personeli</i>	16,400	16,732	16,840	16,051	-332	98%
<i>Operative</i>	6,605	11,753	12,263	13,638	-5,147	56%
<i>Të tjera</i>	119	0	177	91	119	
<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>8,407</b>	<b>500</b>	<b>4,227</b>	<b>5,837</b>	<b>7,907</b>	<b>1683%</b>
<b>TOTALI</b>	<b>31,531</b>	<b>28,984</b>	<b>33,506</b>	<b>35,617</b>	<b>2,547</b>	<b>109%</b>

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2020 është rreth 52%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 21% ndaj totalit të shpenzimeve, ndërsa ato për investime rreth 27%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2019 jepet si më poshtë:



## 046 Këshilli i Qarkut Dibër


Gjatë vitit 2020, Qarku Dibër ka realizuar **224 mijë lekë të ardhura**, të cilat zënë 1.7 % të të ardhurave të mbledhura nga qarqet, duke e renditur qarkun Dibër në vendin e 10-të, të renditjes së qarqeve sipas realizimit të të ardhurave. Në realizimin e të ardhurave, 224 mijë lekë, ose 100 % janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2019, të ardhurat e vitit 2020 të Qarkut Dibër janë ulur me 11.5 %, si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave nga tarifat administrative.

Në vitin 2020, Këshilli i Qarkut Dibër ka realizuar në total 25,914 mijë lekë shpenzime. Në krahasim me vitin 2019, këto shpenzime janë ulur me rreth 22,798 mijë lekë, ku në vitin 2019 ato ishin rreth 48,713 mijë lekë. Në tabelën e mëposhtme, jepen shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në fakt:

në mijë lekë

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferencat vjetore 2020-2019	Raporti i ndryshimit
	2020	2019	2018	2017		
<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>25,676</b>	<b>35,731</b>	<b>29,896</b>	<b>23,540</b>	<b>-10,055</b>	<b>72%</b>
<i>Personeli</i>	16,526	16,914	17,519	15,701	-388	98%
<i>Operative</i>	6,943	7,687	8,128	5,523	-744	90%
<i>Të tjera</i>	2,207	11,131	4,249	2,317	-8,923	20%
<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>239</b>	<b>12,982</b>	<b>0</b>	<b>732</b>	<b>-12,743</b>	<b>2%</b>
<b>TOTALI</b>	<b>25,914</b>	<b>48,713</b>	<b>29,896</b>	<b>24,273</b>	<b>-22,798</b>	<b>53%</b>

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2020 është rreth 64%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 27% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 9%, ndërsa ato për investime rreth 1%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2019 jepet si më poshtë:



## 047 Këshilli i Qarkut Durrës


Gjatë vitit 2020, Qarku Durrës ka realizuar **402 mijë lekë të ardhura**, të cilat zënë 3 % të të ardhurave të mbledhura nga qarqet, duke e renditur qarkun Dibër në vendin e 5-të, të renditjes së qarqeve sipas realizimit të të ardhurave. Në realizimin e të ardhurave, 41 mijë lekë, ose 10.16 % janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2019, të ardhurat e vitit 2020 të Qarkut Durrës janë gjashtëfishuar si rezultat i përmirësimit të procesit të mbledhjes së të ardhurave tatimore dhe jotatimore.

Në vitin 2020, Këshilli i Qarkut Durrës ka realizuar në total 64,925 mijë lekë shpenzime. Në krahasim me vitin 2019, këto shpenzime janë ulur me rreth 4,121 mijë lekë, ku në vitin 2019 ato ishin rreth 69,047 mijë lekë. Në tabelën e mëposhtme, jepen shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në fakt:

në mijë lekë

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferencat vjetore 2020-2019	Raporti i ndryshimit
	2020	2019	2018	2017		
<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>28,926</b>	<b>32,304</b>	<b>30,047</b>	<b>30,217</b>	<b>-3,379</b>	<b>90%</b>
<i>Personeli</i>	16,182	15,723	15,375	17,487	459	103%
<i>Operative</i>	12,743	15,081	14,072	10,358	-2,338	84%
<i>Të tjera</i>	0	1,500	600	2,372	-1,500	0%
<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>36,000</b>	<b>36,743</b>	<b>15,012</b>	<b>14,959</b>	<b>-743</b>	<b>98%</b>
<b>TOTALI</b>	<b>64,925</b>	<b>69,047</b>	<b>45,060</b>	<b>45,176</b>	<b>-4,121</b>	<b>94%</b>

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2020 është rreth 25%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 20% ndaj totalit të shpenzimeve, ndërsa ato për investime rreth 55%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2019 jepet si më poshtë:





## 048 Këshilli i Qarkut Elbasan


Gjatë vitit 2020, Qarku Elbasan ka realizuar **2,629 mijë lekë të ardhura**, të cilat zënë 20 % të të ardhurave të mbledhura nga qarqet, duke e renditur qarkun Elbasan në vendin e 2-të, të renditjes së qarqeve sipas realizimit të të ardhurave. Në realizimin e të ardhurave, 997 mijë lekë, ose 37.9 % janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2019, të ardhurat e vitit 2020 të Qarkut Elbasan janë ulur me 19 %.

Në vitin 2020, Këshilli i Qarkut Elbasan ka realizuar në total 82,091 mijë lekë shpenzime. Në krahasim me vitin 2019, këto shpenzime janë ulur me rreth 3,084 mijë lekë, ku në vitin 2019 ato ishin rreth 85,175 mijë lekë. Në tabelën e mëposhtme, jepen shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në fakt:

në mijë lekë

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferencat vjetore 2020-2019	Raporti i ndryshimit
	2020	2019	2018	2017		
<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>52,041</b>	<b>58,286</b>	<b>46,208</b>	<b>33,621</b>	<b>-6,245</b>	<b>89%</b>
<i>Personeli</i>	16,292	15,622	15,069	15,528	669	104%
<i>Operative</i>	5,320	7,287	9,778	6,203	-1,967	73%
<i>Të tjera</i>	30,429	35,377	21,362	11,891	-4,948	86%
<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>30,050</b>	<b>26,889</b>	<b>23,208</b>	<b>13,338</b>	<b>3,161</b>	<b>112%</b>
<b>TOTALI</b>	<b>82,091</b>	<b>85,175</b>	<b>69,416</b>	<b>46,959</b>	<b>-3,084</b>	<b>96%</b>

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2020 është rreth 20%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 6% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 37%, ndërsa ato për investime rreth 37%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2019 jepet si më poshtë:



## 049 Këshilli i Qarkut Fier


Gjatë vitit 2020, Qarku Fier ka realizuar **105 mijë lekë të ardhura**, të cilat zënë 0.8 % të të ardhurave të mbledhura nga qarqet, duke e renditur qarkun Fier në vendin e 12-të, të renditjes së qarqeve sipas realizimit të të ardhurave. Në realizimin e të ardhurave, 100 % e tyre janë të ardhura jotatimore. Krahasuar me vitin 2019, të ardhurat e vitit 2020 të Qarkut Fier janë ulur me 63.6 %.

Në vitin 2020, Këshilli i Qarkut Fier ka realizuar në total 35,558 mijë lekë shpenzime. Në krahasim me vitin 2019, këto shpenzime janë rritur me rreth 6,289 mijë lekë, ku në vitin 2019 ato ishin rreth 29,269 mijë lekë. Në tabelën e mëposhtme, jepen shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në fakt:

në mijë lekë

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferencat vjetore 2020-2019	Raporti i ndryshimit
	2020	2019	2018	2017		
<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>26,986</b>	<b>29,150</b>	<b>28,348</b>	<b>27,269</b>	<b>-2,164</b>	<b>93%</b>
<i>Personeli</i>	15,772	16,390	15,942	15,395	-618	96%
<i>Operative</i>	11,213	12,306	12,279	11,665	-1,093	91%
<i>Të tjera</i>	0	453	127	209	-453	0%
<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>8,572</b>	<b>119</b>	<b>2,884</b>		<b>8,453</b>	<b>7216%</b>
<b>TOTALI</b>	<b>35,558</b>	<b>29,269</b>	<b>31,232</b>	<b>27,269</b>	<b>6,289</b>	<b>121%</b>

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2020 është rreth 44%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 32% ndaj totalit të shpenzimeve, ndërsa ato për investime rreth 24%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2019 jepet si më poshtë:



## 011 Këshilli i Qarkut Gjirokastrë


Gjatë vitit 2020, Qarku Gjirokastrë ka realizuar **347 mijë lekë të ardhura**, të cilat zënë 2.6 % të të ardhurave të mbledhura nga qarqet, duke e renditur qarkun Gjirokastrë në vendin e 6-të, të renditjes së qarqeve sipas realizimit të të ardhurave. Në realizimin e të ardhurave, 304 mijë lekë, ose 87.5 % janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2019, të ardhurat e vitit 2020 të Qarkut Gjirokastrë janë ulur me 0.6 %.

Në vitin 2020, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë ka realizuar në total 33,482 mijë lekë shpenzime. Në krahasim me vitin 2019, këto shpenzime janë ulur me rreth 11,256 mijë lekë, ku në vitin 2019 ato ishin rreth 44,738 mijë lekë. Në tabelën e mëposhtme, jepen shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në fakt:

në mijë lekë

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferencat vjetore 2020-2019	Raporti i ndryshimit
	2020	2019	2018	2017		
<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>26,848</b>	<b>28,283</b>	<b>29,282</b>	<b>25,490</b>	<b>-1,435</b>	<b>95%</b>
<i>Personeli</i>	16,049	16,069	15,697	15,424	-20	100%
<i>Operative</i>	10,289	11,694	12,844	9,914	-1,405	88%
<i>Të tjera</i>	510	520	741	151	-10	98%
<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>6,634</b>	<b>16,455</b>	<b>9,867</b>	<b>13,204</b>	<b>-9,821</b>	<b>40%</b>
<b>TOTALI</b>	<b>33,482</b>	<b>44,738</b>	<b>39,148</b>	<b>38,694</b>	<b>-11,256</b>	<b>75%</b>

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2020 është rreth 48%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 31% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 2%, ndërsa ato për investime rreth 20%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2019 jepet si më poshtë:



## 015 Këshilli i Qarkut Korçë


Gjatë vitit 2020, Qarku Korçë ka realizuar **338 mijë lekë të ardhura**, të cilat zënë 2.57 % të të ardhurave të mbledhura nga qarqet, duke e renditur qarkun Korçë në vendin e 7-të, të renditjes së qarqeve sipas realizimit të të ardhurave. Në realizimin e të ardhurave, 338 mijë lekë, ose 100 % janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2019, të ardhurat e vitit 2020 të Qarkut Korçë janë ulur me 37.5 %.

Në vitin 2020, bashkia Këshilli i Qarkut Korçë ka realizuar në total 79,823 mijë lekë shpenzime. Në krahasim me vitin 2019, këto shpenzime janë rritur me rreth 19,066 mijë lekë, ku në vitin 2019 ato ishin rreth 60,757 mijë lekë. Në tabelën e mëposhtme, jepen shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në fakt:

në mijë lekë

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferencat vjetore 2020-2019	Raporti i ndryshimit
	2020	2019	2018	2017		
<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>29,729</b>	<b>34,727</b>	<b>35,163</b>	<b>25,968</b>	<b>-4,998</b>	<b>86%</b>
<i>Personeli</i>	15,322	14,984	16,864	15,849	338	102%
<i>Operative</i>	9,301	15,103	14,963	9,785	-5,801	62%
<i>Të tjera</i>	5,106	4,640	3,336	334	466	110%
<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>50,094</b>	<b>26,031</b>	<b>716</b>		<b>24,064</b>	<b>192%</b>
<b>TOTALI</b>	<b>79,823</b>	<b>60,757</b>	<b>35,879</b>	<b>25,968</b>	<b>19,066</b>	<b>131%</b>

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2020 është rreth 19%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 12% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 6%, ndërsa ato për investime rreth 63%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2019 jepet si më poshtë:



## 018 Këshilli i Qarkut Kukës


Gjatë vitit 2020, Qarku Kukës ka realizuar **275 mijë lekë të ardhura**, të cilat zënë 2.1 % të të ardhurave të mbledhura nga qarqet, duke e renditur qarkun Kukës në vendin e 8-të, të renditjes së qarqeve sipas realizimit të të ardhurave. Në realizimin e të ardhurave, 225 mijë lekë, ose 92.7 % janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2019, të ardhurat e vitit 2020 të Qarkut Kukës janë shtatëfishuar si rezultat i përmirësimit të procesit të mbledhjes së të ardhurave tatimore dhe jotatimore.

Në vitin 2020, Këshilli i Qarkut Kukës ka realizuar në total 25,673 mijë lekë shpenzime. Në krahasim me vitin 2019, këto shpenzime janë ulur me rreth 15,172 mijë lekë, ku në vitin 2019 ato ishin rreth 40,845 mijë lekë. Në tabelën e mëposhtme, jepen shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në fakt:

në mijë lekë

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferencat vjetore 2020-2019	Raporti i ndryshimit
	2020	2019	2018	2017		
<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>25,673</b>	<b>34,699</b>	<b>44,661</b>	<b>25,042</b>	<b>-9,027</b>	<b>74%</b>
<i>Personeli</i>	15,880	15,761	15,460	13,123	119	101%
<i>Operative</i>	8,693	12,439	24,718	5,553	-3,745	70%
<i>Të tjera</i>	1,100	6,500	4,482	6,365	-5,400	17%
<b>Shpenzime Kapitale</b>		<b>6,145</b>	<b>79</b>		<b>-6,145</b>	<b>0%</b>
<b>TOTALI</b>	<b>25,673</b>	<b>40,845</b>	<b>44,740</b>	<b>25,042</b>	<b>-15,172</b>	<b>63%</b>

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2020 është rreth 62%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 34% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 4%, ndërsa ato për investime rreth 0%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2019 jepet si më poshtë:



## 020 Këshilli i Qarkut Lezhë


Gjatë vitit 2020, Qarku Lezhë ka realizuar **6,970 mijë lekë të ardhura**, të cilat zënë 53 % të të ardhurave të mbledhura nga qarqet, duke e renditur qarkun Lezhë në vendin e 1-të, të renditjes së qarqeve sipas realizimit të të ardhurave. Në realizimin e të ardhurave, 6,901 mijë lekë, ose 99 % janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2019, të ardhurat e vitit 2020 të Qarkut Lezhë janë katërfishuar, si rezultat i arkëtimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.

Në vitin 2020, Këshilli i Qarkut Lezhë ka realizuar në total 46,574 mijë lekë shpenzime. Në krahasim me vitin 2019, këto shpenzime janë rritur me rreth 13,058 mijë lekë, ku në vitin 2019 ato ishin rreth 33,516 mijë lekë. Në tabelën e mëposhtme, jepen shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në fakt:

në mijë lekë

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferencat vjetore 2020-2019	Raporti i ndryshimit
	2020	2019	2018	2017		
<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>34,115</b>	<b>33,456</b>	<b>32,592</b>	<b>33,755</b>	<b>659</b>	<b>102%</b>
<i>Personeli</i>	19,720	22,300	21,669	23,192	-2,580	88%
<i>Operative</i>	13,495	6,106	5,774	5,563	7,389	221%
<i>Të tjera</i>	900	5,050	5,150	5,000	-4,150	18%
<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>12,459</b>	<b>60</b>	<b>465</b>		<b>12,399</b>	<b>20765%</b>
<b>TOTALI</b>	<b>46,574</b>	<b>33,516</b>	<b>33,057</b>	<b>33,755</b>	<b>13,058</b>	<b>139%</b>

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2020 është rreth 42%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 29% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 2%, ndërsa ato për investime rreth 27%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2019 jepet si më poshtë:



### 033 Këshilli i Qarkut Shkodër


Gjatë vitit 2020, Qarku Shkodër ka realizuar **906 mijë lekë të ardhura**, të cilat zënë 6.9 % të të ardhurave të mbledhura nga qarqet, duke e renditur qarkun Shkodër në vendin e 3-të, të renditjes së qarqeve sipas realizimit të të ardhurave. Në realizimin e të ardhurave, 332 mijë lekë, ose 36.7 % janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2019, të ardhurat e vitit 2020 të Qarkut Shkodër janë tetëfishuar, si rezultat i përmirësimit të procesit të mbledhjes së të ardhurave tatimore dhe jotatimore.

Në vitin 2020, Këshilli i Qarkut Shkodër ka realizuar në total 38,004 mijë lekë shpenzime. Në krahasim me vitin 2019, këto shpenzime janë ulur me rreth 41,684 mijë lekë, ku në vitin 2019 ato ishin rreth 79,688 mijë lekë. Në tabelën e mëposhtme, jepen shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në fakt:

në mijë lekë

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferencat vjetore 2020-2019	Raporti i ndryshimit
	2020	2019	2018	2017		
<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>24,276</b>	<b>24,495</b>	<b>37,372</b>	<b>25,204</b>	<b>-219</b>	<b>99%</b>
<i>Personeli</i>	15,846	15,647	15,443	15,425	199	101%
<i>Operative</i>	7,174	6,958	9,431	6,771	216	103%
<i>Të tjera</i>	1,256	1,890	12,497	3,008	-634	66%
<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>13,728</b>	<b>55,193</b>	<b>58,627</b>	<b>2,948</b>	<b>-41,465</b>	<b>25%</b>
<b>TOTALI</b>	<b>38,004</b>	<b>79,688</b>	<b>95,999</b>	<b>28,152</b>	<b>-41,684</b>	<b>48%</b>

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2020 është rreth 42%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 19% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 3%, ndërsa ato për investime rreth 36%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2019 jepet si më poshtë:



### 035 Këshilli i Qarkut Tiranë


Gjatë vitit 2020, Qarku Tiranë ka realizuar **273 mijë lekë të ardhura**, të cilat zënë 2.1 % të të ardhurave të mbledhura nga qarqet, duke e renditur qarkun Tiranë në vendin e 9-të, të renditjes së qarqeve sipas realizimit të të ardhurave. Në realizimin e të ardhurave, 273 mijë lekë, ose 100 % janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2019, të ardhurat e vitit 2020 të Qarkut Tiranë janë ulur me 18.2 %.

Në vitin 2020, Këshilli i qarkut Tiranë ka realizuar në total 103,463 mijë lekë shpenzime. Në krahasim me vitin 2019, këto shpenzime janë ulur me rreth 15,552 mijë lekë, ku në vitin 2019 ato ishin rreth 119,015 mijë lekë. Në tabelën e mëposhtme, jepen shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në fakt:

në mijë lekë

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferencat vjetore 2020-2019	Raporti i ndryshimit
	2020	2019	2018	2017		
<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>29,454</b>	<b>31,588</b>	<b>31,439</b>	<b>28,378</b>	<b>-2,133</b>	<b>93%</b>
<i>Personeli</i>	15,604	15,441	15,812	15,740	163	101%
<i>Operative</i>	10,624	10,501	10,088	7,412	123	101%
<i>Të tjera</i>	3,227	5,646	5,539	5,226	-2,420	57%
<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>74,008</b>	<b>87,427</b>	<b>33,098</b>	<b>48,521</b>	<b>-13,419</b>	<b>85%</b>
<b>TOTALI</b>	<b>103,463</b>	<b>119,015</b>	<b>64,538</b>	<b>76,899</b>	<b>-15,552</b>	<b>87%</b>

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2020 është rreth 15%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 10% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 3%, ndërsa ato për investime rreth 72%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2019 jepet si më poshtë:





### 037 Këshilli i Qarkut Vlorë


Gjatë vitit 2020, Qarku Vlorë ka realizuar **491 mijë lekë të ardhura**, të cilat zënë 3.7 % të të ardhurave të mbledhura nga qarqet, duke e renditur qarkun Vlorë në vendin e 4-t, të renditjes së qarqeve sipas realizimit të të ardhurave. Në realizimin e të ardhurave, 491 mijë lekë, ose 100 % janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2019, të ardhurat e vitit 2020 të Qarkut Vlorë janë ulur me 36 %.

Në vitin 2020, Këshilli i Qarkut Vlorë ka realizuar në total 69,691 mijë lekë shpenzime. Në krahasim me vitin 2019, këto shpenzime janë rritur me rreth 33,008 mijë lekë, ku në vitin 2019 ato ishin rreth 36,683 mijë lekë. Në tabelën e mëposhtme, jepen shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik, në fakt:

në mijë lekë

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik				Diferencat vjetore 2020-2019	Raporti i ndryshimit
	2020	2019	2018	2017		
<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>26,811</b>	<b>25,546</b>	<b>34,703</b>	<b>30,280</b>	<b>1,265</b>	<b>105%</b>
<i>Personeli</i>	16,113	17,030	16,883	16,568	-917	95%
<i>Operative</i>	7,084	5,958	6,302	5,541	1,126	119%
<i>Të tjera</i>	3,614	2,558	11,518	8,171	1,056	141%
<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>42,880</b>	<b>11,137</b>	<b>1,693</b>	<b>470</b>	<b>31,744</b>	<b>385%</b>
<b>TOTALI</b>	<b>69,691</b>	<b>36,683</b>	<b>36,396</b>	<b>30,751</b>	<b>33,008</b>	<b>190%</b>

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2020 është rreth 23%, shpenzimet operative faktike zënë rreth 10% ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzime të tjera rreth 5%, ndërsa ato për investime rreth 62%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale si dhe nga të ardhurat e veta. Raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2020 dhe 2019 jepet si më poshtë:



\*Në llogaritjen e të ardhurave të veta nuk janë përfshirë të ardhurat që klasifikohen si grante nga buxheti i pushtetit qendror ose vendor.

\*Në llogaritjen e peshës që zënë taksat në totalin e të ardhurave të veta, janë marrë në shqyrtim vetëm taksat kryesore, pa përfshirë tarifën vendorë për zënie e hapësirave publike, tarifën e pastrimit dhe higjienës, grupin 'taksa të tjera' dhe të ardhurat jotatimore.

## 6. Objektivat e treguesve të financave publike vendore për vitin 2021

Fokusi kryesor në vitin 2021 për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë do të jetë vazhdimi i konsolidimit të procesit të menaxhimit financiar në nivel vendor në funksion të vazhdimit të zbatimit të reformës administrativo-territoriale dhe decentralizimit fiskal të njësisve të vetëqeverisjes vendore. Disa tregues të reformës së financave publike në nivel vendor me një efekt pozitiv në buxhetin e vitit 2021 në krahasim me buxhetin vendor para reformës administrativo-territoriale, pritet të jenë si më poshtë vijon:

- ◆ Buxheti vendor i vitit 2021, do të jetë rreth **89 përqind** më i lartë se buxheti vendor para reformës administrativo –territoriale.
- ◆ **Do të përmirësohet menaxhimi i financave vendore përmes rritjes së peshës së taksave lokale në të ardhurat vendore.** Të ardhurat e veta të pushtetit vendor nga viti 2013 në vitin 2021 kanë pësuar një rritje të ndjeshme me rreth **14.6 miliard lekë** ose **dy herë** më shumë se në vitin 2013 dhe në vitin para reformës administrativo-territoriale;
- ◆ Do të rritet mbështetja e dhënë nga buxheti qendror për pushtetin vendor në formën e transfertave ku më e rëndësishmja është rritja e transfertës së pakushtëzuar nga **12.1 miliard lekë** në vitin 2013, në **18.2 miliard lekë** në vitin 2021 ose rreth **50 %** më shumë financim nga pushteti qendror.
- ◆ Të ardhurat e bashkive nga taksat e ndara, gjithashtu do të rriten me rreth **900 milion lekë** për vitin 2021, përfshirë këtu shpërndarjen e tatimit mbi të ardhurat personale për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe krahasuar me vitin 2013 dhe vitin para reformës administrativo-territoriale (2015) janë **900 milion lekë** më shumë në buxhetin vendor;
- ◆ Reforma e iniciuar nga Qeveria (Ministria e Financave dhe Ekonomisë) në taksën e pasurisë do të reflektohet në rritjen e të ardhurave të pushtetit vendor nga **2.4 miliard lekë** në 2013 në **5.6 miliard lekë** në 2021, ose mbi **dy herë** më shumë.
- ◆ Në buxhetin e vitit 2021, do të akordohet për njësitë e vetëqeverisjes vendore transfertë specifike për emergjencat civile në vlerën e **500 milion lekë**;
- ◆ Lidhja e transfertës me 1 përqind të PBB-së, garanton stabilitet, parashikueshmëri dhe rritje me rritjen e ekonomisë;
- ◆ Kalimi efektiv dhe eficient i kompetencave dhe përgjegjësive, në funksion të reformës së re administrativo-territoriale. Pas reformës admininstrativo-territoriale në nivel vendor janë transferuar 7 funksione (Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi, Administrimi i Pyjeve, Ujitja dhe Kullimi, Arsimit Parashkollor) duke u mbështetur financiarisht edhe në vitin 2021 në **vlerën 8 miliard lekë** në formën e transfertës së pakushtëzuar sektoriale.
- ◆ Këto funksione të decentralizuar që në vitin 2016, vazhdojnë të mbështeten çdo vit me fonde buxhetore. Në buxhetin e vitit 2021, transfertat e pakushtëzuara sektoriale të:
  - Arsimit parashkollor janë rritur me **4 përqind**;
  - Arsimit parauniversitar me **3 përqind**;
  - Shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi **6 përqind**;

- Administrimit të pyjeve me **10 përqind**; dhe
  - Ujitjes dhe kullimit janë rritur me **6 përqind**.
- ◆ Në vijim të reformës administrativo-territoriale dhe decentralizimit, vend të rëndësishëm zë vazhdimi dhe konsolidimi i reformës së financimit të arsimit parashkollor. Përmes buxhetit të vitit 2021, do të vazhdojë mbështetja financiare për reformën në arsimin parashkollor me synim konsolidimin e një skeme financimi të përshtatshme dhe efektive që synon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve.
- ◆ Në buxhetin e vitit 2021, njësive të vetëqeverisjes vendore u është akorduar një fond për mbrojtjen civile prej 500 milion lekë. Ky fond është shpërndarë me një formulë e cila bazohet në peshën specifike që zë buxheti i çdo bashkie ndaj totalit të buxhetit të të gjitha bashkive. Pjesën tjetër të fondit bashkitë mund ta sigurojnë nëpërmjet përdorimit të fondit rezervë dhe të kontigjencës ose/dhe pjesë nga buxhetet e tyre (transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore). Ky fond i akorduar njësive të vetëqeverisjes vendore së bashku me fondin që këto do të adresojnë përbën fillimin e një reforme të rëndësishme për mbrojtjen civile.

## 7. Konkluzione dhe Synimet në vijim

Gjatë vitit 2020, një situatë e jashtëzakonshme shëndetësore dhe shoqërore ndikoi gjithashtu ekonominë globale ku përfshihet edhe Shqipëria. Pushteti vendor në Shqipëri u prek nga kjo situatë e cila imponoi ndryshime në disa elementë të rëndësishëm të menaxhimit financiar publik në tërësi për të cilën janë të nevojshme përgatitja e skenarëve për ngjarje të ngjashme në të ardhmen. Përfshirja në manualët e menaxhimit financiar të rasteve të jashtëzakonshme tashmë është një detyrë që eksperiencën e vitit 2020 ta përdorë si shembull për ngjarje të njëjta që mund të përsëriten në të ardhmen. Duke u mbështetur mbi treguesit pozitivë të ecurisë së decentralizimit fiskal dhe rritjes së cilësisë së Menaxhimit Financiar Publik në nivel vendor, Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të vazhdojë të ndjekë me fokus të veçantë thellimin e reformave. Gjatë vitit 2021, do të vazhdohet ndjekja me intensitet e ecurisë së implementimit të reformave të ndërmarra në menaxhimin financiar publik si në nivel qendror ashtu edhe në nivel vendor. Ruajtja e trendit pozitiv të ecurisë së konsolidimit financiar në nivel vendor dhe zbatimi i plotë tek të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore i të gjitha metodologjive të hartuara janë tregues të rëndësishëm për ecurinë e punës së MFE. Në këtë këndvështrim, disa nga rekomandimet që dalin nga raporti i treguesve të realizimit të buxhetit vendor 2020 janë si më poshtë:

- Ruajtja e qëndrueshmërisë së Transfertës së pakushtëzuar pavarësisht rënies së ndjeshme të Produktit të Brendshëm Bruto si pasojë e pandemisë COVID-19;

Rregulli fiskal i ligjit për financat vendore ku përcaktohet që transfertat e pakushtëzuar duhet të jetë jo më pak se 1% e PBB-së dhe efektet e para pozitive një vit ndryshe për Produktin e Brendshëm Bruto sic ishte ai i vitit 2020 si pasojë e pandemisë COVID-19. Ky rregull fiskal dha një impakt shumë pozitiv për pushtetin vendor, duke ruajtur të njëjtën nivel të transfertës së pakushtëzuar për pushtetin vendor pavarësisht krizës së prodhimit të brendshëm gjatë vitit 2020. Konsolidimi fiskal dhe qëndrueshmëria e financave të pushtetit vendor gjatë vitit 2020, janë tregues të rëndësishëm i forcimit të aftësisë së pushtetit vendor për ofrimin e shërbimeve publike.

- Ruajtja e niveleve të të ardhurave të veta vendore në nivele të kënaqshme pavarësisht rënies ekonomike gjatë vitit 2020;

Një ndër treguesit më të rëndësishëm të konsolidimit fiskal të njësisë të vetëqeverisjes vendore do të jetë rritja e aftësive të tyre për të siguruar të ardhura nga burimet e veta dhe arkëtimin e tyre në mënyrë të qëndrueshme në kohë. Gjatë vitit 2020, pushteti vendor pati një rënie të të ardhurave të veta vetëm 5% krahasuar me një vit më parë. Kjo rënie e të ardhurave të pushtetit vendor paraqitet në një masë të vogël në raport me situatën pandemike në tërësi e cila vendosi në mjaft vështirësi financat publike. Situata pandemike u shoqërua me rishikimin e buxhetit për shumicën e njësisë të vetëqeverisjes vendore, rishpërndarje të fondeve në ato programe të cilat lidheshin drejtpërdrejtë me menaxhimin e pandemisë, shtyrje dhe përjashtim për disa kategori të pagesave për taksat dhe tarifatat vendore, faktorë të cilët ndikuan drejtpërdrejt në treguesit financiar fiskal të pushtetit vendor. Në vijim, është shumë e rëndësishme që në raste të ngjashme njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të kenë një përgjigje të shpejtë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në rishikimin e politikës fiskale, me qëllim nxitjen e ekonomisë lokale dhe uljen e barrës fiskale.

- Rënia e ndjeshme e shpenzimeve për investime gjatë vitit 2020, është tregues i brishtësisë së shpenzimeve të kësaj natyre në rastet e vështirësive financiare

Rënia e ndjeshme e shpenzimeve për investime gjatë vitit 2020, ishte burimi që u prek më shumë në raport me të gjitha shpenzimet e tjera vendore. Rikuperimi i investimeve të prapambetura dhe ruajtja e trendit të vitit 2019 është një sfidë e rëndësishme në buxhetin vendor 2021. Menaxhimi financiar në nivel vendor është përmirësuar ndjeshëm, duke nxitur rritjen e shpenzimeve që kanë efekt të drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së qytetarëve dhe rritja e investimeve vendore është një prej këtyre shpenzimeve më të rëndësishme. Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet ti japin prioritet zbatimit të atyre projekteve të investimeve që kanë ndikim më të madh në zhvillimin e ekonomisë vendore dhe në hapjen e vendeve të reja të punës.

- Ruatja e standardeve ligjore për buxhetimin mbi bazë programi dhe funksioni në të gjitha njësitë vetëqeverisjes vendore

Viti 2021 do të jetë një vit i rëndësishëm jo vetëm në procesin e ringritjes ekonomike dhe të treguesve fiskalë të pushtetit vendor por gjithashtu edhe të vendosjes së plotë të standardeve ligjore të miratuara. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, do të konsolidojnë ecurinë e përdorimit të standartit të unifikimit të shpenzimeve vendore jo vetëm në nivel llogarie ekonomike por gjithashtu edhe programi e funksioni. Me përfundimin i këtij procesi do të përmbillet një etapë të rëndësishme në rrugën drejt unifikimit në AFMIS të të gjithë njësive të vetëqeverisjes vendore.

- Asistenca e drejtpërdrejtë gjatë viti 2021 për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore në drejtim të implementimit të plotë të kërkesave ligjore dhe nënligjore për menaxhimin financiar në nivel vendor.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë vitit 2021 përmes strukturave të saj do të asistojë të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore në mënyrë të drejtpërdrejt në implementimin e plotë të proceseve të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe monitorimit të buxhetit në përputhje me kërkesat ligjore mbi bazë programesh dhe treguesish performance. Konsolidimi i këtij procesi është një hap i madh drejt modernizimit të menaxhimit financiar në nivel vendor, duke rritur transparencën dhe llogaridhënien mbi përdorimin e fondeve publike.

- Rritjes së eficiencës në ofrimin e shërbimeve publike në nivel vendor përmes rritjes së cilësisë, administrimit dhe qeverisjes më të mirë të financave publike.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Ministrinë e Linjës dhe gjithashtu përmes treguesve të performancës në monitorimin e buxhetit vendor, do të synojë rritjen e cilësisë së monitorimit të shërbimeve publike vendore në funksion të rritjes së cilësisë së tyre. Përmes raporteve të përcjella do të synohet krijimi i një baze të rëndësishme informacioni për matjen e ecurisë së implementimit të reformave nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe përmirësimit që kanë pësuar shërbimet vendore.

- Zhvillimit ekonomik lokal dhe në uljen e pabarazive midis njësive të vetëqeverisjes vendore.

Pushteti vendor si pjesë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik kombëtar ka në thelb nxitjen e politikave të zhvillimit rajonal. Një ekonomi e fortë lokale do të përkthehet në një ekonomi të qëndrueshme kombetare dhe sigurisht mirëqenie me të lartë për qytetarët. Instrumentet financiarë të vetëqeverisjes vendore duhet të orientohen në funksion të zhvillimit ekonomik dhe uljen e pabarazive mes njësive në funksion të zhvillimit kombëtar.

- Rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes vendore në raport me komunitetin.

Një sfidë e rëndësishme për tu thelluar në qeverisjen vendore mbetet rritja e transparencës dhe llogaridhënjes përmes pjesëmarrjes qytetare në proceset e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm. Një pushtet vendor i konsoliduar do të thotë një trasparencë më e madhe në lidhje me punën e zhvilluar për arritjen e objektivave. Në këto kushte, gjatë vitit 2021 e në vazhdim Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të synojë nxitjen e njësive të vetqeverisjes vendore në ndërmarrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e transparencës përmes publikimit dhe hartimit të buxhetit të qytetarit.

- Forcimit të rregullave dhe procedurave për menaxhimin e financave publike në nivel vendor duke siguruar më shumë disiplinë fiskale në menaxhimin e vështirësive financiare.

Miratimi i Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” është një hap shumë i madh i cili i dha frymë procesit të krimit të rregullave dhe procedurave për menaxhimin financiar publik në nivel vendor dhe menaxhimin të vështirësive financiare. Në këto kushte, janë hartuar të gjithë udhëzimet standarte që përmbyllin plotësisht kuadrin procedural dhe rregullativ të financave në nivel vendor. Duke ndjekur trendin e viteve të pas reformës administrative territoriale, gjatë vitit 2021 do të synohet rritja e kapacitetit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe gjithashtu përmirësimi i shërbimeve publike të ofruara për qytetarët. Ministria e Financave dhe Ekonomisë në mënyrë të vazhdueshme do të ndjekë e monitorojë procesin e menaxhimit financiar në nivel vendor dhe përmes tyre vlerësimin e treguesve të performancës së NJVQV-ve. Në këtë kuptim, ky raport do të pasohet nga raporte të tjerë zyrtarë periodike në funksion të transparencës, përgjegjshmërisë dhe pjesëmarrjes së të gjitha grupeve të interesit në procesin e administrimit financiar vendor por gjithashtu ajo që është më e rëndësishmja pjesëmarrja qytetare në këtë proces.









Ky raport është përgatitur me mbështetjen e projektit 'Financat Lokale' nga Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike SECO

**FINANCATLOKALE** | Forcimi i Menaxhimit  
**LOCALFINANCES** | të Financave Publike  
të Qeverisjes Vendore



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike, SECO**